

numër 6
shtator 2016

toka

IME

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

GËZUAR PËRVJETORI - 1 VIT REVISTË REGJIONALE!



PANAIRI I PRODHIMEVE BUJQËSORE,
BLEGTORALE DHE PUNIMEVE TE DORËS

Të fuqishme, të vlefshme, por të varfra



Me sistem
shpalir në
rendimet prej
100 deri në
150 t/ha



Shkencëtarët
krijuan domate,
më të zeza nuk
mund të ketë



Ruajtja
e perimeve
periudhën
e dimrit



“Lëkura
me gunga”
po zgjerohet
në Ballkan

Përmbajtja

Përmbajtje në Maqedoni :
U SHKATËRRUA
PRODHIMI BUJQËSOR
NË SHKUP



6



Kopshtaria:
SI TË BËHET KORRJA
DHE RUAJTJA E
RREGULLT

10

Pemëtari:
35.000 EURO
PËR PRODHIM TË
ÇIPSIT PREJ MOLLE



18



Mekanizim:
KOMBAJNË PËR
MBLEDHJEN E DOMATEVE

22



FEDERATA E FERMERËVE NË R.M.

Adresa: rr. Gigo Mihajovski nr.4/1-1 1000 Shkup
Tel:389 02 3099 044, Faks:389 02 3099 044
e-mail: ffrm@ffrm.org.mk
uebfaqe:www.ffrm.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 (0)44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org



WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me organizatat partnere në mbi 20 vende, me vizion të botës së qëndrueshme dhe të drejtë të çliuar nga varfëria. WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të përforcet zëri i përbashkët i bujqve.

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FFRM, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit të suazat e sektorit bujqësor.



FEDERATA E FERMERËVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Toka ime, Shtator 2016

Botues: FFRM

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Gigo Mihajlovski, nr. 4-1/1,
1000 Shkup

Udhëheqës: Bllagojçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042

e-mail: mojazemja@gmail.com

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska

Botuar më:
Shtator 2016

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Gazetar: Monika Risteska

Bashkëpunëtorë profesionale

Dr. Vitor Malutaj, inxh. agr. dipl. Jelica Beshliq, Tomi Pikuli,
Nikolin Karapanci, Sabah Djaloshi, Doruntina Kurteshi,
Ekrem Bajrami, Dr. Dragi Tanevski, Ilir Gashi, Besmira Alia,
Rade Karanfilovski, inxh. agr. dipl. Savka Markudova, as. dr.
Zvezda Bogevska, as. dr. Margarita Davitkovska, inxh. agr.
dipl. Stojan Gligorov, Vladimir Millanoviq

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

Revista "Toka ime" financohet tërësisht nga Agjencia Internacionale Suedeze për Bashkëpunim (Sida) dhe We Effect. Qëndrimet e prezantuara në këtë revistë nuk janë me patjetër edhe qëndrime të Sida dhe We Effect. Pronarët mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen.

SUKSESI I PËRBASHKËT



Bashkimi rajonal dhe përforsimi i përbashkët nëpërmjet zërit të bujkut. Kjo ishte ideja dhe aksioni ynë i përbashkët kur para një viti me ndihmë të We Effect filluam ta nxjerrim numrin e parë të revistës Toka Ime. Ja pas një viti 11000 vizita në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Pikërisht në këtë vit që po kalon ekipi i kreatorëve të Tokës sime punuan në krijimin e një reviste rajonale e cila do të dëshmojë se janë të domosdoshëm bashkëpunimi dhe lidhja në rajon që të ketë çfarëdolloj përparimi ekonomik. Mbetet ende punë dhe mund i përbashkët për përparimin tonë të mëtejshëm.

Këtë numër ua dedikojmë grave fermerë të cilat energjinë e vet e drejtojnë kah punës, mundit me qëllim që sigurojnë ekzistencën e vet dhe të gjejnë fuqi në vetvete që të luftojnë me varfërinë.

Pikërisht siç thotë edhe organizata WeEffect mungesa e kushteve të barabarta nënkupton se gratë e varfra shesh trajtohen si qytetarë të rendit të dytë, që e rrezikon dhe pjesëmarrjen e tyre të tërësishme në shoqëri dhe në zhvillimin e tyre. Mungesa e fuqisë të gratë do të thotë se zëri i tyre nuk dëgjohet sa duhet dhe kontributi i tyre në zhvillimin e shoqërisë është marginalizuar dhe është më pak

i dukshëm. Barazia gjinore është e drejta themelore e njeriut. Barazia gjinore nënkupton se gratë, burrat, vajzat dhe djemtë i kanë të njëjtat mundësi dhe të drejta në të gjitha aspektet e zhvillimit njerëzor.

Gjatë gjithë këtyre viteve që punoj me fermerët, kam njohur shumë gra, të cilat me veprimtarinë, ambicien e tyre dëshmojnë se suksesi është qëllimi i tyre në jetë. Pikërisht kjo i bën më të fuqishme dhe i bashkon edhe më tepër në realizimin e aktiviteteve dhe qëllimeve të veta. Puna dhe entuziazmi e tyre, përkushtimi ndaj familjes dhe fëmijëve i bën luftëtare të vërteta dhe shembuj në këtë shoqëri sesi ne të tjerët duhet të veprojmë.

Pikërisht veprimtaria e përbashkët është element i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe ballafaqimin me problemet siç është edhe shfaqja e dëmtuesve dhe sëmundjeve të reja. Një prej këtyre problemeve është edhe shfaqja e sëmundjes të lopët "lëkura me gunga", për të cilën theksi i veçantë vendoset te numri i bagëtive prekura. Përmbytjet në Republikën e Maqedonisë bënë dëme të mëdha dhe pikërisht qasja rajonale mundëson luftë të përbashkët në përstatjen e bujqësisë ndaj kohës së re.

Nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve dhe bashkëpunimit të përbashkët mund të bëhen hapa të cilat çojnë përpamë në këtë sektor të rëndësishëm ekonomik për të gjithë ne. Kjo shpjegohet në aktivitetet e FFRM-së, IKC-së, Agrinetit dhe Agropukës të mbështetura nga organizata suedeze WeEffect për zhvillim të bujqësisë dhe shoqërimin kooperativ në rajon.

Dhe në fund në emër të të gjithë ekipit i cili punon në përgatit revistën Toka Ime Ju urojmë 15 Tetorin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale dhe Ju dëshirojmë sukses dhe bereqet edhe mandej.

Me respekt,
Biljana Petrovska-Mitrevska
Redaktore e revistës „Toka Ime”

Së bashku drejt suksesit



FFRM-ja, së bashku me shoqërinë e vet anëtare “Bllagoj Kotllarovski” dhe AgriNet nga Republika e Shqipërisë organizuan në Resnjë takim të përbashkët të kultivuesve të mollës nga Prespa dhe Korça, ku u bisedua mbi problemet dhe sfidat në kultivimin e mollës. Problem i përbash-

kët është plasmani, çmimi i ulët blerës dhe manipulimet nga blerësit me shumicë. Ata theksuan se kushtet jo të mira kohore si dhe ngrica në periudhën e pranverës shkaktoi dëme të mëdha mbi prodhimin e mollës. Takimi u mbajt gjatë manifestimit “Vjelja e mollëve në Prespë” me të

cilin u shënuar edhe fillimi i vjeljes. Gjatë takimit kultivuesit e mollës nga Shqipëria e vizituan laboratorin për analiza të truallit, i cili është një prej shërbimeve të shoqatës “Bllagoj Kotllarovski” dhe pemëtarinë bashkëkohore me mollë me stacion meteorologjik të instaluar.

Fermerë të bashkuar dhe menaxherë profesionale

- receta për kooperativë të suksesshme

Sekreti i suksesit të kooperativave sllovene

Shkruan: Bllagojçe Najdovski

Kohë më parë një grup përfaqësues të FFRM-së kishin mundësi të vizitojnë disa kooperativa në Republikën e Sllovenisë. Ajo që ishte e përbashkët pothuajse te të gjitha kooperativat që i vizituam dhe njëkohësisht është shkak për shoqërimin e tyre, e cila ka qenë zgjidhje e përbashkët e problemit të cilin e kanë

pasur fermerët, por individualisht nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje. Ngjashmëri tjetër ishte fakti se në krye të të gjitha kooperativave kanë qëndruar profesionistë me arsim të lartë dhe menaxherë më përvojë shumë vjeçare, të cilët udhëheqin me qarkullim vjetor deri në 50 milion euro.

Kooperativa e parë ishte kooperativa bujqësore "Vinska klet Goriska Brda" ku 400 prodhues të rrushit të bashkuar në kooperativë kanë verarinë e tyre e cila është njëra nga më të mëdhatë në Slloveni. Ajo e eksporton verën e prodhuar nga lloji vendas Rebulla në mbi 26 shtete. Tregimi i tyre fillon menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ku rrethina e Nova Gorica, e ka eksportuar frytin e parë në Perandorinë e madhe Austro - Hungareze dhe rajoni ka qenë i njohur për qershitë e para. Fermerët i kanë plasuar qershitë e tyre në Oborin Austriak në Vjenë dhe kanë pasur të ardhura të shkëlqyera, por pas shkatërrimit të Austro - Hungarisë, rajoni i Dobrevës dhe Goricës kanë rënë në sundimin Italian. Qershitë e tyre aspak nuk kanë pasur çmim të mirë sepse në Itali ka pasur tepër dhe askush nuk ka dashur ti blerë qershitë të cilat

janë pjekur dukshëm më vonë, ndërsa Italianët aspak nuk kanë qenë të interesuar ti blenë. Kështu, brenda natës situata është ndryshuar dhe fermerët janë përballur me varfëri të madhe. Si rezultat i kësaj njerëzit kanë filluar në mënyrë masive të migrojnë në shtetet tej oqeanike, ndërsa ata që kanë ngelur është dashur të përshtaten dhe të prodhojnë diçka që do të kërkohet në Itali. Rajoni në Goricë, ka klimë të butë mesdhetare për shkak të afërsisë së Detit Adriatik, por edhe afërsia e Alpeve bën që të ketë klimë unike mesdhetare - kontinentale. Prandaj fermerët kanë filluar të prodhojnë verë. Në fillim gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore janë shoqëruar disa prodhues të rrushit dhe e kanë siguruar shtypësen e parë për rrudh, ndërkaq shumë shpejt janë organizuar në kooperativë. Në vitin 1957 e kanë ndërtuar kantinën e verës me kapacitet prej disa milion litra.

Me aderimin e Sllovenisë në Bashkimin Evropian, kooperativa përsëri është përballur me problem të ngjashëm, me çka pas aderimit të Sllovenisë në Bashkimin Evropian, vera sllovene në konkurrencë me verërat Italiane dhe Franceze ishte jo konkurrense. Por, kjo nuk i ç'inkurajoi anëtarët e kooperativës. Ata kanë angazhuar menaxher me cilësi të larta profesionale i cili ka bërë ri brendimin e verarisë. Ai e ka zgjeruar asortimentin në verëra të bardha, të kuqe dhe me shukumë dhe e zmadhoi asortimentin në mbi 250 lloje

të verës nga njëra anë por edhe depërtoi në tregjet e huaja.

Menaxheri, që ti realizojë të gjitha ndryshimet, me kooperativën kanë krijuar edhe sistem të ri të kontrollit të kooperativistëve të vetë kooperativës në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qëllim të evitohet ndikimi i anëtarëve të kooperativës në drejtimin operativ të kooperativës. Kooperativa ka krijuar sistem indirekt për kontrollin e menaxhmentit të kooperativës. Sipas atij sistemi, kuveni i përgjithshëm i kooperativës i përbërë nga 400 anëtarë, zgjedh trupin me 30 anëtarë, ndërsa nga ky trup zgjidhet trup i ri prej 10 anëtarë. Ata së bashku me menaxherin dhe përfaqësuesit e të punësuarve e përbëjnë këshillin drejtues dhe në këtë mënyrë menaxheri ka liri operative të udhëheqë me kooperativën. Anëtarët e kooperativës, nga ana tjetër kanë drejtimin indirekt të kooperativës, ndërsa menaxheri ka marrëveshje për menaxhim që të jetë i stimuluar të punojë. Ai ka autorizime për marrëveshje deri në 100.000 euro, pa pasur nevojë të konsultohet me këshillin që i jep fleksibilitet kooperativës gjatë vendimmarrjes operative.

Anëtarët e kooperativës kanë çmime grumbullimi graduale për rrushin, në pajtim me kualitetin e rrushit ndërsa për kualitetin, agroteknikën dhe mbrojtjen, kooperativa ka punësuar dy agronomë të cilët kujdesen për teknologjinë e prodhimit me çka kualiteti është me prioritet më të madh.





Kmetijska
zadruga Ptuj

Kooperativa e dytë e suksesshme është kooperativa në qytezën e vogël Tolmin e cila është kooperativë kryesisht blegtorale. Ajo merret me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve të qumështit dhe mishit dhe ka edhe zinxhir prej dhjetë dyqaneve vetjake për repromateriale dhe mallra për konsum të gjerë.

Në të kaluarën blegtorët në këtë rajon të Alpeve të Sllovenisë, për shkak të klimës së ashpër janë bashkuar dhe së bashku e kanë bërë djathin dhe e kanë kullotur bagëtinë. Kjo kooperativë, gjithashtu, ka filluar me punë gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, ndërsa gjatë kohës së ish RSFJ-së ka qenë kooperativë ku është prodhuar qumështi pluhur për fabrikën e çokollatave KRASH të Kroacisë. Por, pas pavarësimit të Sllovenisë, prona e kooperativës ka qenë kontestuese dhe anëtarët e kooperativës është dashur të fillojnë nga zero. Në veçanti interesante ishte edhe konkluda e menaxherit të kooperativës Nikollaj Maver: "Në njerëzit që jetojmë në mal kemi mësuar nëpër shekuj se me komshiun nuk guxon të hidhërohesh deri në fund të jetës. Kur do të shaheni me komshiun, dhe njëkohësisht jetoni në rajon malor duhet ta dini se ai nesër ndoshta do të ketë rendësi jetësore për ju. Mali di të jetë i pa mëshirshëm dhe pikërisht ai mentalitet është kyç për bashkimin në kooperativa."

Anëtarët e Kooperativës kanë rënë dakord, se të gjithë fitimin do ta ri investojnë, ndërsa kooperativa do tua blerë qumështin dhe bagëtinë me çmime të drejta. Për këtë qëllim kanë angazhuar menaxher të aftë profesional, me të cilin me kalimin e viteve kanë ndërtuar perandori të vogël me qumështoren e tyre. Ajo prodhon produkte të gatshme të qumështit të cilat shiten në rrjetin e tyre personal që përbëhet nga dhjetë dyqane dhe mishtore. Çmimi i grumbullimit të qumështit është 40 euro centa që është pothuajse për dyfish më e lartë se qumështoret konkurruese në Slloveni, kur secili punon në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa fermerët prodhojnë lëndë të parë të cilësisë së lartë (qumësht dhe mish). Menaxheri profesional, kujdeset për prodhimin dhe tregtinë, ndërsa anëtarët kanë besim tek ai. Edhe në këtë kooperativë, kryesor ishte besimi ndërmjet anëtarëve, por edhe menaxheri profesional i cili është i motivuar të investohet në zhvillimin e kooperativës. Nga njëra anë në ri investimin e fitimit në prodhim dhe tregti, por edhe në shtimin e vlerës së produkteve themelore të kooperativës, qumështit dhe mishit në produktet finale të brenduara. Kaçkavall, djathë, suxhuk dhe shumë produkte të tjera me vlerë të shtuar" - theksoi menaxheri, kur e pyetëm cili është çmimi i drejtë i grumbullimit të qumështit.

Tregimi i tretë i suksesshëm është i ngjashëm me dy të parit. Kjo kooperativë gjendet në qytezën Ptuj, dhe ajo ka fabrikën e saj për shtrydhjen e vajit nga kungulli, por edhe zinxhir të barnatoreve bujqësore dhe dyqaneve për repromateriale për fermerë. Qarkullimi vjetor është mbi 50 milion euro. Vuajtja i ka bashkuar fermerët në rrethinën e qytezës Ptuj, ku gjatë kohës së RSFJ-së ka pasur prodhim të madh të panxhar sheqerit, por pas aderimit të Sllovenisë në BE dhe privatizimi i prodhueses së sheqerit, ajo nuk ka grumbulluar më nga fermerët dhe ata kanë qenë të gjejnë kulturë alternative. Zgjidhjen e kanë gjetur me bashkimin në kooperativë dhe prodhimin e farave të kungullit për vaj nga farat e kungullit. Kooperativa ka siguruar pajisje për shtrydhjen e vajit nga farat e kungujve dhe ka angazhuar menaxher profesional i cili së bashku me anëtarët e këshillit drejtues kanë realizuar një tregim të suksesshëm. ●



U shkatërrua prodhimi bujqësor në Shkup

Shkruan: Biljana Petrovska-Mitrevska

Dëme të mëdha mbi bujqësinë shkaktuan përmbytjet të cilat e përfshinë Ballkanin. Pikërisht dëme të tilla bëri dhe përmbytja e fundit e cila e përfshiu rajonin e Shkupit në Republikën e Maqedonisë në gusht. Dëme më të mëdha shkaktoi në fshatrat Stajkovci dhe Haračinë.

Sipas popullatës lokale gjatë përmbytjes janë formuar tri lumenj të cilët kanë rrjedhur drejt fshatrave. "Ishte e tmerrshme në rrugët rajonale u formuan tre lumenj sa vetë Vardari dhe një u fut në Stajkovci, tjetri në Hasanbeg, kurse i treti nga Haračina përfundoi në fushën e Haraçinës", tregon Afrim Sulejmani nga Haračina, i cili ka kooperativë bujqësore në Haračinë. Dëm më të madh përmbytja shkaktoi në Stajkovci në shtëpitë e popullatës, kurse dëmi më i madh në prodhimin bujqësor është shkaktuar në fushën e Haraçi-

nës dhe në rajonin bujqësor përreth Stajkovcit. I gjithë prodhimi i kopsh-tarisë (domate, speca, kastravecë, patate, qepë) dhe i fushës (misër dhe duhan) është shkatërruar.

"Tamam arritëm te vjelja dhe na mori gjithçka përmbytja", thotë Sulejmani. Ai nuk ka pësuar dëm të madh, sepse kooperativa e tij merret me prodhimin e grurit dhe ai ishte korrur sepse korrja në rajonin e Shkupi ka përfunduar tashmë që në fillim të korrikut. Dëm i madh është bërë edhe mbi mekanizimin dhe pajisjen për bujqësi siç janë sistemet pikë për pikë, serrat, traktorët dhe kombajnat.

Nga ajo që thonë vetë bujqit rrjedh se dëmi më i madh nga përmbytja është bërë nga faktori njeri, përkatësisht kanalet e pa pastruara dhe prerja e pyjeve nëpër kodra.

Gjithashtu vetëm 1% e sipërfaqeve bujqësore janë të siguruar.

Gjatë rrugës që e lidh Hasanbegun me Haračinën gjendet kompania bujqësore ShPK Singeliç e cila ka 20 traktorë, 6 kombajna, makina për grurë dhe 700 hektarë të cilat i jep me qira për përpunim, si dhe fermë blegtorale prej 15 lopësh. Pikërisht kjo firmë gjatë përmbytjes dukej si ujëvarë, i gjithë uji i rrugës rajonale është futur në këtë kompani dhe i gjithë mekanizmi është shkatërruar, përkatësisht nuk punon.

"U kthym 40 vjet pas. Ne jemi tre vëllezër dhe punojmë në këtë firmë së bashku me 120 punëtorë dhe tani gjithçka na është shkatërruar. Të gjithë traktorët dhe kombajnat nuk punojnë, gruri është prishur, tre lopë na u mbytën, na është shkatërruar sipërfaqja që e kemi dhënë me qira. Në të vërtetë uji në firmë arriti lartësi prej 3 metrash dhe traktorët dhe kombajnat kanë qenë të mbuluar me ujë", thotë Riza Sulejmani, një prej pronarëve të kompanisë.

Punëtorët në kompaninë e tij thonë se vetë përmbytja ka qenë e tmerrshme mezi kanë arritur t'i shpëtojnë gratë dhe fëmijët të cilët kanë qenë në dasmë në restorantin që gjendet në afërsi të firmës.

Për ballafaqim me fatkeqësitë e tilla natyrore nevojitet veprimi i përbashkët në rajon, dhe edukim dhe informim më i madh i popullatës dhe kjo kryesisht për popullatën rurale të cilët jo vetëm që kanë pasur pasojat më të mëdha mbi shtëpitë e tyre, por edhe një pjesë e madhe e sipërfaqeve bujqësore nga të cilat nxjerrin ekzistencën u janë shkatërruar dhe kështu kanë pësuar më tepër dëmtime nga ndryshimet klimatike. ●



Sëmundja gungore e lëkurës PO ZGJEROHET NË BALLKAN

Shkruan:

Monika Risteska

Sëmundja dermatoza nodulare (lëkura me gunga) është sëmundje virale dhe nuk ekziston rrezik mbi shëndetin e njerëzve. Sëmundja e lëkurës me gunga është sëmundje virale e gjedhit dhe dallohet qartë nga nyjat në lëkurën e gjithë sipërfaqes së trupit. Sëmundja e tuberkulozes së lëkurës (lëkura me gunga) është sëmundje me rëndësi të madhe për situatën sociale-ekonomike sepse prej saj mund të preken më tepër se 50% e fermave blegtore, kurse vdekshmëria e kafshëve të prekura nga kjo sëmundje mund të arrijë deri në 10%. Humbjet e tjera përfshijnë reduktim të prodhimit të qumështit, reduktim të pjellshmërisë dhe dëmtim të përhershëm të lëkurës së kafshës. Pikërisht kjo sëmundje virale shkaktoi dëme të mëdha në blegtori në tërë rajonin. Lëkura me gunga dallohet prej faktit se shkakton temperaturë të lartë trupore te kafshët deri në 40o Celsius, shfaqen ndryshime nyjore në lëkurë, ulet prodhimi i qumështit, sekrecion nga hunda dhe sitë dhe dukuri e abortimit të kafshët e sëmura. Sëmundja mund të transmetohet nga insektet (mushkonjat dhe mizat e stallës), direkt nëpërmjet kontaktit midis kafshës së sëmurë dhe të shëndetshme ose indirekt nëpërmjet ushqimit të sëmurë, ujit, jashtëqitjes, materialeve dhe pajisjeve të infektuara.

Blegtorëve u rekomandohet t'i mbajnë gjedhët të mbyllura në stalla dhe të mos i lëshojnë të kullosin, të mos i përziejnë me gjedhë të tjerë, në stalla të vendosen rrjete për mbrojtje nga insektet dhe të bëjnë rregullisht dezinfeksion dhe dezinfektim, të përdorin mjete kundër insekteve që t'i mbrojnë kafshët nga thumbimi prej insekteve.



Gjithashtu, rekomandohet stalla të ketë një hyrje dhe një dalje nga ferma/stalla, të përdoret veshje mbrojtëse gjatë punës e cila duhet të dezinfektohet rregullisht, të izolohehen kafshët e sëmura prej të shëndoshave, sipas mundësisë në vend më vete, kurse punëtorët që punojnë me kafshë të sëmura të mos kenë qasje te kafshët e shëndetshme në fermë.

Në republikën e Maqedonisë u shfaq në pjesën jugore dhe në periudhën e pranverës, kështu që filloi me edukimin e blegtorëve për mbrojtje të lopëve nga lëkura me gunga dhe me vaksinim të gjedhëve.

Nikolin Karapançi nga AgriNet, Shqipëria, sëmundja lëkura me gunga është një shqetësim i madh në Evropë, si rezultat i zgjerimit të saj në Izrael (2012), Turqia (2013), Azerbajxhani (korrik 2014), Rusia (Korrik 2015), Greqia (gusht 2015) dhe gjatë vitit 2016 zgjerohet në Ballkan.

Më 7 korrik, 2016 ekspertë nga shërbimet veterinarë kanë identifikuar raste me shenja klinike të sëmundjes lëkurë me nyje në rajonin e Dibrës, pranë kufirit me Maqedoninë. Për të konfirmuar diagnozën, ata kanë marrë rezultatet e analizave të Institutit për Referencë në Bullgari, dhe

pasi sëmundja është konfirmuar nga shteti janë marrë masat e duhura.

Në fshatin Zhoje - Kamenica në Kosovë muajin e kaluar është identifikuar rasti i lëkurës me nyje te gjedhët. Rasti është diagnostikuar nga rezultatet laboratorike, ku është bërë eliminimi i kafshëve të infektuara, siç informon Agjencia për Ushqim dhe Veterinari e Kosovës. Sipas tyre nga kjo sëmundje në Kosovë kanë ngordhur 200 lopë. «Në bazë të drejtimit të përhapjes së sëmundjes, ne si një autoritet i mobilizojë të gjitha mundësitë që kemi, në koordinim me autoritetet e tjera lokale dhe rajonale për të bërë më të mirën që mundemi për të pasur sa më pak apo aspak kafshë të infektuara. Ne do të jemi të përkushtuar që të sigurojmë vaksinën kundër kësaj sëmundje si masa më efektive për të parandaluar përhapjen e saj, «- vuri në dukje Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës. Nga Kosova shtojnë se javën e kaluar numri i vaksinave nga Afrika e Jugut ka arritur 235 mijë doza. Ato janë dorëzuar tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për shpërndarje në vendet e prekura nga sëmundja lëkura me gunga te gjedhi. ●



Gjatë kësaj periudhe nën drejtimin e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në Shqipëri janë marrë masat e mëposhtme:

- * Është vendosur një strategji e veçantë për monitorimin, frenim dhe ndalimin e përhapjes së sëmundjes;
- * Është ndaluar lëvizja e kafshëve si brënda vëndit por dhe import – eksporti i tyre deri në kontrollin e plotë të situatës;
- * Është ndaluar tregëtimi i kafshëve por dhe i mishit të tyre në tregjet vëndase;
- * Është zbuluar një vatër e madhe e infeksionit me rreth 400 kafshë të prekura, kryesisht në zonat verilindore të Shqipërisë (Dibër, Kukës dhe Has), të cilat u vranë për të parandaluar përhapjen e sëmundjes;
- * Është kryer vaksinimi i të gjithë gjedhëve në Shqipëri.

Masat e mësipërme janë marrë për një periudhë të caktuar, derisa gjendja është vënë nën kontroll dhe normalizuar.

Aplikimi i mënyrës vertikale të kultivimit, respektivisht, shpalir, si teknologji më e re, po shënon rritje të konsiderueshme kudo nëpër botë. Më i mirë është treguar konstruksioni me dy radhë bimë nga të dyja anët e sistemit vertikal në 30 cm larg konstruksionit dhe me distancë në radhët nga 30 cm. Distanca ndërmjet dy radhëve të konstruksionit duhet të jetë 150 cm për shkak të kryerjes së operacioneve të punës dhe transportit. Nëse trangujt e vegjël kultivohen në sera tunele plastike, si shtylla mbështetëse mund të shfrytëzohet edhe konstruksioni i tunelit plastik.

Me sistem shpalir në rendimet prej 100 deri në 150 t/ha



Shkruan: Inxhinier i diplomuar, agronom Savka Markudova

Prodhimi i trangujve të vegjël për nevojat e industrisë ushqimore, vitet e fundit u tregua si mjaft interesante dhe fitimprurëse për prodhuesit bujqësor për shkak të plasmanit të sigurt, ndërsa nga ana tjetër, përparësi e trangujve të vegjël është se mund të mbillen si kulturë e dytë në sipërfaqen e njëjtë në fushë të hapur dhe në hapësirë të mbrojtur.

Kultivimi i trangujve të vegjël, mund të bëhet me vjelje të drejtpërdrejtë me rasat që paraprakisht është mbjellë në saksi ose në kontejnerë. Nga teknologjitë e reja të cilat aplikohen në botë edhe të për realizimin e rendimentit të madh është kultivimi me rasat të prodhuar paraprakisht. Prodhiimi i rasatit duhet të fillojë rreth një muaj para mbjelljes. Si kulturë tipike e familjes Cucurbitaceae, është shumë e ndjeshme ndaj lëndimeve të sistemit të rrënjës dhe prandaj gjatë prodhimit të rasatit, duhet të evitohen çfarë do lloj lëndime të sistemit të rrënjës, që do të thotë se prodhimi i rasatit duhet të jetën në kuti ushqyese, saksi ose në kontejnerë. Rasati gjatë kohës së mbjelljes duhet të ketë formuar katër gjethe të përherëshme.

Trangujt e vegjël mund të mbillen në dy mënyra:

1. **Mënyra standarde** (horizontale – zakonisht në fushë të hapur),
2. **Mënyra shpalire** (vertikale me mbështetës) më tepër aplikohet në hapësirë të mbrojtur, por edhe në të hapur.

Te mënyra standarde, mbjellja mund të bëhet në radhë me distancë ndërmjet radhëve 100 – 150 cm dhe 20 deri në 30 cm në radhë. Mënyra tjetër është në lenta: 220 cm ndërmjet radhëve me 30 – 60 cm ndërmjet lentave në radhën dhe 20 – 25 cm distancë në vetë radhën nëse përpunohet me makinë, ndërsa për përpunim me dorë distanca ndërmjet radhëve duhet të jetë 150 cm.

Aplikimi i mënyrës vertikale të kultivimit, respektivisht shpalir, si teknologji më e re, po shënon rritje të konsiderueshme kudo nëpër botë. Më i mirë është treguar konstruksioni me dy radhë bimë nga të dyja anët e sistemit vertikal në 30 cm larg konstruksionit dhe me distancë në radhët nga 30 cm. Distanca ndërmjet dy radhëve të konstruksionit duhet të jetë 150 cm për shkak të kryerjes së operacioneve të punës dhe transportit. Nëse trangujt e

MENAXHIMI I SËMUNDJEVE

Gjatë vegjetacionit, bimët duhet të kultivohen me kujdes. Zakonisht mjaftojnë 2 - 3 prashitura. Kur kultivohen në mënyrën shpalire, kërcelli rregullohet me përdredhje dhe lidhjen e bimës për konstruksionin e serës dhe largohen filizat anësore dhe lulët në lartësi prej 40 deri në 60 cm nga kërcelli kryesor. Pastaj filizat anësore shkurohen në 3 gjethe dhe 2 fruta. Kur maja e kërcellit do të arrijë deri në telin kryesor, përdridhet për poshtë. Përveç gjatë kohës kur lëshon filiza, kur trangulli kultivohet në mënyrën shpalire, kryhet edhe pastrimi nga gjetheet e vjetër me qëllim të sigurohet ajrosje më e mirë dhe parandalimi i zhvillimit të sëmundjeve.

Paralelisht në mënyrë të rregullt kryhet edhe mbrojtja e preventive nga sëmundje dhe insekte sepse trangujt janë të rrezikuar nga më shumë sëmundje: Vrugu, antraknoza, hiri i gjetheve, sëmundje të shkaktuara nga baktere dhe virozë.

Hibridet më të reja, janë rezistente ndaj disa prej këtyre sëmundjeve.

vegjël kultivohen në sera tunele plastike, si shtylla mbështetëse mund të shfrytëzohet edhe konstruksioni i tunelit plastik.

Me kultivimin e mënyrës shparlir, bimët fitojnë mjaft përparësi, respektivisht më shumë dritë, ajër dhe mundësi për mbrojtje më efikase nga sëmundjet dhe insektet. Përveç kësaj, frutat zhvillohen në mënyrë të rregullt, më lehtë vilen dhe formojnë shumë pak fruta të deformuar. Në këtë mënyrë vazhdohet jetëgjatësia e bimës, periudha pjellore, ndërsa me këtë rritet edhe rendimenti i përgjithshëm edhe deri në 100%.

Nga teknologjitë më të reja, në prodhimin e trangujve të vegjël, në botë është i përfaqësuar mjaftë edhe prodhimi me mbulim, gjatë kësaj përdoren materiale të ndryshme me origjinë organike dhe jo organike, ndërsa zakonisht përdoren mbulesa polietileni. Mbulesa shërben për rritjen e temperaturës së tokës dhe rrualtjen



e lagështisë, me çka rritet aktiviteti mikrobiologjik në zonën e sistemit të rrënjës dhe sasia e dyoksidit të karbonit në tokë, ndërsa kjo ndikon në rritjen më intensive të bimëve të reja. Gjithashtu, i parandalon farën e keqe dhe e zvogëlon dorën e punës. Ekzistojnë rezultate të shumta nga hulumtime të cilat e konfirmojnë efektin e konsiderueshëm të mbulimit në rritjen e rendimentit të trangujt prej 30 deri në 100%.

Koha më e volitshme për mbjellje është dekada e parë e majit, ndërsa për prodhim më të vonshëm mund të mbillen deri në fund të qershorit. Trangujt piquen për korrje për



UJITJE

Ujitja duhet të kryhet rregullisht në kushte klimatike me diell dhe me kohë të nxehtë dhe në javë rekomandohet sasi prej 30 deri në 40 mm. ujë për metër katror në fushë të hapur. Më mirë është ujitja të kryhet në orët e hershme të mëngjesit për dy shkaqe: Më dobët zhvillohet vrugu për shkak të tharjes së shpejtë të gjetheve më arritjen e pjesës më të nxehtë të ditës dhe evitohet fitimi i frutave të hidhur sepse nëse ujitet bimë «e nxehtë» më ujë të ftohtë, zakonisht ndodh shok i cili ndikon në vazhdimin e kohës që nevojitet nga pllenimi deri në vjelje, dhe me këtë nga ana tjetër, fryti do të jetë më i hidhur. Trangujt e vegjël në mënyrë më intensive ujitjen kur do të fillojë vjelja që të arrihen rendimente optimale.

40 - 45 ditë mbas mbirjes. Për zhvillimin e frytit nga lulëzimi deri në pjekjen teknologjike, nevojiten 5-7 ditë. Periudha e pjellore zgjat 30 - 40 ditë, varësisht nga koha e vjeljes së frutave dhe gjendja shëndetësore e të mbjellave. Trangujt vilen çdo ditë ose çdo të dytën ditë. Vjelja duhet të kryhet me kujdes që të mos lëndohen bimët gjatë këputjes ose mos shkelen. Duhet rregullisht të këputen të gjitha futat e rritura, të deformuara ose të sëmura. Ndikim të madh mbi rendimentin ka vjelja e rregullt e frutave, sepse vjelja e vonuar e ndalon lulëzimin e frutave të reja.

Gjatë mënyrës standarde, tradicionale me investime më të vogla në prodhim dhe aplikimin e agro teknikës së mirë, rendimenti është 30 - 50 t/ha, ndërsa gjatë mënyrës shpalirski me aplikimi prodhimit të rasatit dhe mbulimit rendimenti është mbi 100 deri në 150 t/ha. ●



Tharja është operacioni më i rëndësishëm i teknologjisë pas korrjes së qepës. Me këtë reduktohen humbjet pas korrjes dhe humbjet nga lagështia, sepse largohet teprica e lagështisë nga luspat e thata mbështjellëse të jashtme dhe nga qafa e qepëve të sapokorrura në një nivel që do ta minimizojë humbjen dhe rrudhjen nga brendia dhe do të çojë në uljen e infeksionit mikrobiologjik. Nëse tharja kryhet në fushë, temperatura nuk duhet të jetë më e ulët se 24°C. Përveç tharjes natyrore, praktikohet dhe ajo e forcuar - tharja me ajër. Rezultatet më të mira arrihen në temperaturë prej rreth 38°C.



SI TË BËHET KORRJA DHE RUAJTJA E RREGULLT

Shkruajnë: as. dr. Xezda Bogevska,
as. dr. Margarita Davitkovska



Si me të gjitha kulturat kopshtare, ashtu edhe te qepa është e rëndësishme korrja dhe ruajtja. Ajo për çka duhet të kenë kujdes fermerët është që korrja e qepëve të bëhet në mot të thatë, sepse në qoftë se ajo është në shi ose kur lagështia është e lartë, rritet ndjeshmëria ndaj sëmundjeve pas korrjes. Gjatë kohës së korrjes, qepujkat duhet të jenë të ngurta, me qafë të pjekur dhe të mbyllur, me luspa mbështjellëse dhe me dimensione adekuate (madhësi). Qysh gjatë vetë korrjes, qepujkat defekte (të dëmtuara nga insektet, me djegie, të pjekura dhe të dëmtuarat) duhet të hidhen.

Sipas disa hulumtimeve, nëse përqindja e pemëve të rreme të shtrira është 20-50%, redukton përhapjen gjatë magazinimit, prandaj ulet ren-

dimenti i përgjithshëm për 15% në krahasim me të korrurat kur përqindja e pemëve të rreme të shtrira është 80%. Rezultatet e studimeve të tjera, megjithatë, kanë treguar se korrja mund të prolongohet deri në 100% pjekja pa u rritur humbja e marketingut gjatë magazinimit ose të bjerë cilësia gjatë afatit. Megjithatë, në praktikë është pranuar që vjelja të kryhet kur do të shtrihet 50-80% e masës mbitokësore.

Qepa vilet me dorë dhe mekanikisht. Vjelja me dorë bëhet me shkulje, ndërsa e mekanizuar zakonisht në dy faza (së pari nxirret qepa dhe lihet në shirita të thatet 5-10 ditë, pastaj mbledhet dhe çohet në depo).

Periodha e tharjes është operacioni më i rëndësishëm në teknologjinë e pas vjeljes së qepës. Me këtë reduktohen humbjet pas vjeljes dhe humbjet nga lagështia për shkak se largohet teprica e lagështisë nga

Magazinimi i duhur

Kushtet e rruajtjes. Temperatura optimale është 0-2°C dhe lagështia relative 65-70% (shtrirja 65-80%).

Ftohja e shpejtë nuk është e nevojshme. Nëse dëshirohet që qepa të magazinohet kohë më të gjatë, atëherë është e domosdoshme ulja e shpejtë e temperaturës në nivel të duhur.

Kohëzgjatja e magazinimit. Në kushtet të temperaturës dhe lagështisë optimale, qepët mund të rruhen me sukses nga 1 deri në 8 muaj në varësi të llojit.

Pika e ngrirjes: -0,8°C

Atmosfera e kontrolluar. Te llojet që karakterizohen me potencial të gjatë të magazinimit nuk është vërejtur ndonjë përfitim nga përdorimi i atmosferës së kontrolluar. Qepujka mund të jetë e dëmtuar nëse atmosfera e magazinimit e oksigjenit është më pak se 1%, dhe përmbajtja e monoksidit të karbonit është mbi 10%. Përdorimi komercial i atmosferës së kontrolluar prej 3% O₂ dhe 5-7% CO₂ është e rekomanduar për ruajtjen e llojeve të ëmbla të qepës me potencial të ulët të magazinimit.



Prishja gjatë ruajtjes

Përhapja është problemi më i madh gjatë magazinimit dhe shkakton humbje të mëdha. Me zbatimin e kushteve të rekomanduara, problemet, d.m.th. humbjet gjatë magazinimit janë të zvogëluara. Gjatë magazinimit mund të ndodhin çrregullime fiziologjike - luspave të qullëta të cilat për herë të parë u shfaqën në Evropën veriore. Vetë procesi i shfaqjes së luspave të qullëta quhet teoria e mbytjes. Korrrjet e vonshme, temperaturat e larta të tharjes ose shërimit, si dhe tharja më afatgjatë janë shkak për paraqitjen e luspave të qullëta.

Për të shmangur çrregullime fiziolo-gjike të tilla, është e rekomanduar:

- Korrrja e hershme (jo më vonë se 50 deri në 80% të shtrirjes së masës mbiotkësore);
- Trajtimi i kujdesshëm i qepujkave;
- Të shmangen korrrjet gjatë motit me lagështi;
- Tharja të bëhet në kuti dhe jo në grumbuj të lartë për ta shmangur presionin;
- Temperatura e tharjes të jetë <25°C (temperatura të tilla të larta përdoren për ngjyrosje më të errët të luspave)

luspave të jashtme mbështjellëse dhe qafa e qepës së sapo vjelë deri në nivel i cili do të minimizonte humbjen dhe rrudhjen nga brenda dhe do të rezultojë me uljen e infeksionit mikrobiologjik. Nëse tharja kryhet në fushë, temperatura nuk duhet të jetë më e ulët se 24°C. Përveç natyrores, praktikohet edhe e forcuara - tharja me ajër. Rezultatet më të mira arrihen në temperaturë prej rreth 38°C dhe lagështi relative jo më të lartë se 80% për një periudhë prej rreth një jave.

Me tharjen zvogëlohet masa e qepujkave dhe për shkak se ato shiten më së shumti në bazë të masës së tyre, arritja e nivelit të dëshiruar të dehidratimit është kritike. Humbjet në peshë prej 3 deri në 5% janë normale në kushte ambientale të tharjes deri në 10% gjatë tharjes (së detyrueshme).

Në Angli, që nga viti 1975 për tharjen e qepujkave aplikohet rrymimi i ajrit në 26-28°. Është e nevojshme të hiqet lagështia e tepërt brenda tre ditëve. Pastaj qepa rruhet në 25 ° C në kohë zgjatje prej 3 deri në 4 javë, me ventilim 2-4 orë në ditë, deri sa nuk thahet qafa. Më pas temperatura ulet dhe mbahet në 0 ° C në ftohës. Sistemet moderne të tharjes me kapacitet prej 2,000 tonë.

Gjatësia e fazës së qëndrimit varet nga lloji dhe kjo do të thotë se suksesi i ruajtjes varet nga lloji. Më së miri rruhen llojet me numër më të madh të fletëve të mbyllura të lëngështa, numri më i madh i fletëve të thata, me jo më shumë se 14% të lëndës së thatë (llojeve djegëse) dhe dysakaride. Llojet me periudhë të shkurtër të qëndrimit rruhen dhe kanë përmbajtje të materieve të thata ndër 10% (llojeve të ëmbla) dhe kanë origjinë nga gjerësitë gjeografike jugore.

Aromën e qepëve shpesh e marrin produkte e tjera në mjedis, kështu që është e dëshirueshme të mbahen të ndara, me përjashtim të disa kulturave të përafërta siç është hudhra.

Qepa para ruajtjes pastrohet nga teprica e fletëve të thata dhe detyrimisht i prihet qafa në gjatësi prej 2 cm. •



SHKENCËTARËT KRIJUAN DOMATE, MË TË ZEZË NUK MUND TË KETË

Shkencëtarët amerikanë krijuan domate me kryqëzim të domateve të egra me domateve të kultivuara. Ngjyra e errët vjen nga pigmenti, i ngjashëm me atë që gjendet në pishat. Ky pigment është i ndjeshëm ndaj ndriçimit, kështu që sa më të gjatë të jetë domatja e pasqyruar në dritën e diellit aq më e errët është ajo. Kompani "Technological Seeds" e cila e krijoi domaten, është e specializuar për prodhimin e farave hibride të perimeve. Përveç ngjyrës interesante, kjo domate ka edhe përparësi në lidhje me përmbajtjen e antioksidantëve. Në të vërtetë, kreatorët e kësaj perime jo të zakonshme thonë se ajo është më ushqyese dhe kjo falë pigmentit unik që ka për qëndrim të lartë të antioksidantëve dhe vitaminës C, të cilat e përforcojnë sistemin imunologjik. Tregu qëllimor i domateve të zeza janë hotelet luksozë, për shkak të pamjes së tyre ekzotike.



Shkruan:
Stojan Gligorov, inxh. agr. dipl.

Qëllimi i ruajtjes së perimeve dhe frutave është që ato të përdoren apo konsumohen në gjendje të freskët për një periudhë kohore sa më të gjatë. Mbajtja më e gjatë në gjendje të freskët të frutave dhe perimeve mundëson konkurrencë më të madhe në treg gjatë gjithë vitit dhe e zvogëlon karakterin sezonal të prodhimeve dhe shitjes. Prandaj është shumë e rëndësishme të zvogëlohen humbjet që në fillim të mbledhjes, perimet duhet të pakëtohen dhe të magazinohen në kushte optimale kështu që gjatë ruajtjes ndryshimet mbi vetë frutën të jenë në minimum, kurse kështu do të realizohen fitime edhe më të mëdha.

Prandaj mënyra e ruajtjes dhe e mirëmbajtjes së perimeve dhe frutave është një prej qëllimeve më të rëndësishme dhe prioritare në prodhimtarinë e tërësishme me qëllim që të mbahet cilësia dhe sasia dhe këto të plasohen për një periudhë më të gjatë në destinacione të caktuara ku do të fitohen çmime më të larta, për shkak të faktit se një prodhim i caktuar është i kërkuar në treg, kurse nuk gjendet në sasi më të mëdha.

Afati i cilësisë dhe ruajtjes së perimeve varet nga kushtet para fillimit të vjeljes, gjatë vjeljes, dhe para së gjithash nga përzgjedhja, paketimi dhe vetë procesi i ruajtjes.

Ruajtja dhe mirëmbajtja e perimeve në gjendje të freskët në periudhën e dimrit

Mënyra e ruajtjes varet nga fakti se për cilat lloj frutash apo perimesh bëhet fjalë: perime rrënjore (karota, rrepa, panxhari, pashkanati, patatja), perime qepujore (qepa, preshi, hudhra), perime gjethore (marulja, spinaqi, lule lakra, lakra, brokulla), domate, specat, kastravec, shalqiri, mashurka, bizelja etj.

Patatja – si kulturë e zakonshme ruhet në periudhë nga 6 deri në 10 muaj dhe kjo në objekte bashkëkohore që janë ndërtuar dhe pajisur në mënyrë speciale. Megjithatë haset edhe ruajtja

në hapësira të podumeve dhe hapësira që janë joadekuate për ruajtje dhe kështu humbjet janë enorme, madje deri në 20%, kurse periudha kohore për ruajtje është më e shkurtër, 3-5 muaj. Gjatë ruajtjes duhet të ketë ventilim që i cili do ta reduktojë përqendrimin e dyoksidit të karbonit dhe sipërfaqja e patates të mbetet e thatë.

Temperatura optimale për ruajtjen e patates për përdorim në treg është rreth 10°C, kurse për përdorim për farë është 2-4°C dhe lagështia rreth 90%. Këto kushte arrihen në komora të ftohta ku temperatura lëviz në varësi nga fakti ku ruhet prodhimi: nëse perimet janë qepujore, nevojitet temperaturë prej 0°C, për perime gjethore, lakër, perime rrënjore 8-10°C, për specat, domate, patëllxhan, 10-15°C gjithashtu edhe për kastravec, shalqinj. Perimet kryesisht vendosen në paleta, kurse midis tyre lihet hapësirë për qarkullim të lirë të ajrit.

Qepa mund të ruhet dhe magazinohet, nëse shkulja bëhet në kohë të caktuar ose kur arrihet





pjekuria e tërësishme. Në këtë rast ekzistojnë standarde për cilësi me zbatimin e të cilave arrihet efekt edhe më i mirë. Kështu, gjatë shkuljes duhet të jenë tërësisht të pjekura dhe është e nevojshme që gjethet e jashtme të jenë të thata që gjatë ruajtjes të mos ketë ndryshim të ngjyrës së qepës. Gjatë shkuljes duhet të kryhet përzgjedhja, d.m.th. të veçohen kokrrat e vogla, të dëmtuara si dhe toka e mbetur në to. Pastaj vendoset në thasë, kuti kartoni, kontejnerë etj. Magazinimi dhe ruajtja e qepës bëhet me qëllim që të vazhdojë periudha e ruajtjes dhe të minimalizohet humbja.

Ekzistojnë normativa të cilat i përcaktojnë parametrat e ruajtjes – temperatura, lagështia relative dhe kohëzgjatja.

Panxhari kultivohet më tepër në Evropën Lindore dhe Qendrore. Ndahet në dy lloje: i hershëm deri në 100 ditë, mesatar nga 100 deri në

130 ditë dhe i vonshëm mbi 100 ditë. Që të mbahet në formë të freskët, ruhet në temperaturë shumë të ulët (0-5°C) dhe në lagështi relativisht të lartë (90-95%). Domethënë, më të përshtatshme janë kushtet kur temperatura është 0°C, kurse lagështia e ajrit është 95-100%. Ruhet 3-5 muaj, por mund të ruhet edhe 6-8 nëse magazina ka kushte optimale. Me rritjen e nivelit të CO₂ ngadalësohet niveli i kalbëzimit. Mundësia për ruajtje më të gjatë të panxharit kufizohet edhe nga lloji, madhësia e rrënjës, përmbajtja e materieve të thata, pjekuria teknologjike dhe kushtet e ruajtjes. Dehidrimin i rrënjës mund të zvogëlohet nëse lagështia e panxharit dhe lagështia e ajrit është më e vogël. Me ruajtjen e panxharit në hapësira podrumi e joadekuata nga 2-3 muaj përmbajtja e betaninës zvogëlohet, kurse me ruajtjen rreth gjashtë muaj kjo mund të zvogëlohet edhe

deri në 10%. Për përdorim vendas dhe sasi më të vogël të përpunimit, me rëndësi të madhe është mbajtja në hapësira dhe objekte siç janë magazinat dhe podrumet, ku kushtet rregullim janë të vështira. Nëse ruhet në podrum, panxhari duhet të ndahet të mos jetë në pirgje të mëdha dhe temperatura duhet të jetë mbi 0°C. Në kushte të tilla mund të ruhet deri në tre muaj, kuptohet nëse mbahet dhe lagështi që mos ketë dehidrim të rrënjës.

Karota – Pjekuria teknologjike ndodh kur gjethet më të vjetra fillojnë të shkatërrohen. Nga pjekuria teknologjike e karotës varet edhe gjatësia e ruajtjes, intensiteti i vyshkjes dhe kalbëzimit. Mbledhja e karotës gjatë tetorit është për ruajtje më të mirë dhe jep rezultate nëse temperaturat nuk janë shumë të ulëta, kurse bimët janë në gjendje të mirë. Karota mund të ruhet në frigoriferë gjatë lagështisë relativisht të lartë nga 96 deri në 100% në temperaturë 0-1 °C gjatë 4-5 muajve. Karota e re dhe e papjekur mund të ruhet 4-6 javë në temperaturë deri në 0°C, nëse është kryer paraprakisht ftohja. Karota së bashku me gjethet ruhet tri javë në 0°C deri në 10 në temperaturë prej 5°C. Karota mund të ruhet së bashku me llojet e tjera bimore, siç janë panxhari, kulturat e lakrës, preshi, sallata. Mund të ruhen në trapa nëntokësorë dhe mbitokësor. Gjatë kësaj duhet të vendoset rërë e imët dhe e lagësht që të ndalojë përhapjen e sëmundjeve dhe avullimin e lagështisë. ●

Shkruan: Biljana Petrovska - Mitrevska

Të fuqishme, të vlefshme, por të varfra

Gratë e mjediseve rurale, kryesisht fermere, përbëjnë një shifër prej të paktën 1,6 miliardë dhe paraqesin më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të popullsisë botërore. Gratë mesatarisht prodhojnë më tepër se gjysmën e të gjithë ushqimit që kultivohet: Deri në 80% në Afrikë, 50% në Azi, ndërmjet 30 % dhe 40% në Amerikën Latine dhe vendet perëndimore. Numri i grave të mjediseve rurale të cilat jetojnë në varfëri u dyfishua që nga viti 1970. Këto janë të dhënat zyrtare të cilat Komiteti e Bashkuara i prezantuan dhe filluan me kremtimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale - 15 tetorin.

Pikërisht këto fakte, aludojnë për rëndësinë e grave rurale në zhvillimin e bujqësisë. Por, megjithatë, edhe më tutje në pjesën më të madhe të rajoneve në zhvillim gjenden në pozitë të palakmueshme, përqindja më e madhe janë të paarsimuar dhe të varfra dhe nuk janë të përfshira në krijimin e politikave agrare. Në lidhje me këtë problematikë në nivel global punohet mjaftë, në drejtim të përforcimit ekonomik të gruas rurale dhe nëpërmjet kësaj do të mundësohet, zhvillimi i gruas dhe vlerësimi i mundit të saj.

Një nga organizatat ndërkombëtare të cilat rëndësi të veçantë i kushtojnë zhvillimit të grave rurale është We Effect. Sipas kësaj organizate, mungesa e kushteve të barabarta do të thotë se gratë e varfra shpesh trajtohen si qytetarë të rendit të dytë, që e cenon pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri dhe zhvillimin e tyre. Mungesa e fuqisë të gratë do të thotë se zëri i tyre nuk njihet mjaftueshëm dhe se kontributi i tyre në zhvil-

limin shoqëror është i marginalizuar dhe më pak i dukshëm. Barazia gjinore është e drejta themelore e njeriut. Barazia gjinore do të thotë se gratë, burrat, vajzat dhe djemtë i gëzojnë mundësitë dhe të drejtat e njëjta për të gjitha aspektet e zhvillimit njerëzor. Kjo do të thotë se gratë dhe burrat gëzojnë shkallë të njëjtë të respektit, i kanë mundësitë e njëjta që të bëjnë zgjidhje dhe fuqi të barabartë të krijojnë përmbajtjen e zgjidhjeve të tyre, me çka kontribuojnë në drejtim të zhvillimit social dhe ekonomik. Anna Erlandson, Menaxhere e Programit të We Effect për BE-në, thekson se roli dhe përgjegjësia e We Effect është të jenë partner gjatë zhvillimit.

„Qëllimi jonë është të kontribuojmë për mjedis më të mirë institucional për avancimin e barazisë gjinore. Më shumë organizata partnere, në veçanti në suazat e programeve për zhvillim rural, janë anëtare dhe kanë pozita udhëheqëse të dominuar nga burrat. Gjithashtu, aktet nënligjore dhe procedurat e favorizojnë përjetësimin e strukturave dhe praktikave patriarkale të cilat i marginalizojnë gratë. We Effect merr pjesë në rritjen e pjesëmarrjes së grave në krijimin e politikave me mbështetjen e strukturave dhe proceseve në organizatat partnere të cilat angazhohen për barazi gjinore (akte nën ligjore, politika për barazi gjinore,

buxhetim transparent për shpërndarjen e drejtë të mjeteve dhe masa të tjera me të cilat do të zvogëlohet hendeku ndërmjet burrave dhe grave). Ne i mbështesim partnerët tanë në Evropë për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe promovimin e grave lidere. Shohim se, kur gratë organizohen në grupe dhe shoqata me aktivitete ekonomike të bashkuara ato jo vetëm që e përmirësojnë mirëqenien e tyre dhe të ardhurat, por gjithashtu rritet edhe ndikimi i tyre në familje dhe në shoqëri në tërësi” - thotë Erlandson.



SHQIPËRI: GRATË BËJNË PUNËN MË TË VËSHTIRË NË FERMAT FAMILJARE DHE NË PËRGJITHËSI NË BUJQËSI

RRITJA E ROLIT TË GRUAS NË ZONAT RURALE

Shqipëria ashtu si shumë vende të Ballkanit është e përbërë nga një shoqëri patriarkale ku përgjithësisht janë burrat ata që përfaqësojnë familjen nëpër shoqatat e fermerëve dhe nëpër kooperativa.

Edhe pse gratë bëjnë punën më të vështirë në fermat familjare dhe në përgjithësi në bujqësi, puna e tyre ende nuk vlerësohet mjaftueshëm. Ato zënë rreth 47% të popullsisë së zonave rurale në Shqipëri. Gratë në zonat rurale janë shpesh të izoluara dhe pak aktive në jetën e përditshme pa pasur mundësi të bashkëveprojnë me shoqërinë dhe të marrin pjesë në aktivitete sociale-ekonomike. Pjesëmarrja e grave në shoqatat e fermerëve dhe në bordet e tyre drejtuese është shumë e ulët dhe si pasojë, zëri i tyre në vendimmarrje është shumë i dobët.

Nisur nga kjo situatë Fondacioni AgriNet Albania, nëpërmjet implementimit të projektit "Zhvillimi i Komunitetit Rural nëpërmjet Shoqatave të Fermerëve" mbështetur nga We Effect (Swedish Cooperative Center) Suedi, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përfshirjes së grave dhe rritjes së rolit të tyre në fermë, familje dhe shoqëri.

Gjatë 5 viteve të fundit të zbatimit të projektit, në tre rajonet ku Fondacioni AgriNet Albania është fokusuar pra në Korçë, Elbasan dhe Peshkopë, janë bërë këto arritje:

- Të paktën 450 gra ose 45% e përfituesve të përfshirë në projekt janë gra;
- 35% e lidershipit në 15 shoqata fermerësh janë përzgjedhur gra;

„Ne i mbështesim partnerët tanë nga Evropa kur bëhet fjalë për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe promovimin e udhëheqjes nga gratë. Shohim se kur gratë organizohen në grupe dhe shoqata me aktivitete ekonomike të bashkuara ato jo vetëm që e përmirësojnë mirëqenien e tyre dhe të ardhurat, por gjithashtu rritet edhe ndikimi i tyre në familje dhe në shoqëri në tërësi. Ja disa shembuj pozitiv nga puna jonë në Evropë” - shton ajo.

- 60% e Këshillit Konsultativ të Fondacioni AgriNet Albania janë gra;
- 80% e grave të përfshira në projekt janë trajnuar në çështje teknike të ndryshme;
- 30% e aktiviteteve teknike janë organizuar me pjesëmarrje të përzierë (burra & gra);
- Është krijuar Forumi i Gruas Rurale Korçë;
- Janë krijuar 6 Rrethe Studimi të përbëra nga gratë;
- Janë nxitur dhe mbështetur rreth 50 gra në iniciativat e tyre të biznesit në fermë;
- Rreth 45 - 47% e investimeve të projektit u është adresuar aktiviteteve me gratë.

Agrinet do të vazhdojë të mbështesë të gjitha iniciativat që japin mundësi zhvillimi për gratë e zonave rurale gjithashtu konsulentë profesionistë që trajtojnë çështje të barazisë gjinore do të kontraktohen dhe do të përfshihen në aktivitetet me gratë, të cilat janë një target grup shumë i rëndësishëm.

Organizata Agropuka nga Shqipëria, gjithashtu, realizon aktivitete midis të cilave janë edhe tryezat e rrumbullakëta ku fton gra-fermere me qëllim që të përfshihen në shoqëri bujqësore dhe të përforcohen dhe zhvillohen ekonomikisht. Një prej atyre grave është edhe Ilirjana Dunga nga fshati Kereti, e cila është një prej prodhuesve të parë të djathit të dhisë. “Së bashku me bashkëshortin tim Beharin, kemi 150 dhi qumësht dhënëse. Filluam vetëm me 3 dhi të blera para disa vitesh me paratë të cilat bashkëshorti im i ka kursyer nga puna në Greqi. Pikërisht nëpërmjet projektit RTM ndërtuam objekt për përpunim të qumështit me kapacitet për përpunim të rreth 300 litrash. Agropuka na mbështet nëpërmjet edukimit

Pikërisht këtë pohim të saj për Toka Ime, e mbështet me dy shembuj të cilat We Effect i realizon nëpërmjet organizatave të saj partnerët në IKS në Kosovë dhe CERD, Bosnjë dhe Hercegovinë. Pikërisht në Kosovë nëpërmjet mbështetjes së organizatës së grave Begunica nga komuna Viti, me trajnime për gatim dhe pajisje për gatimin e petullave, brumërave dhe gurabijeve, rezultoi me sukses për gratë rurale dhe zhvillimin e

duke na ftuar të marrim pjesë në rrethin studimor të rritësve të bagëtisë që ishte finalizuar me themelimin e grupit tematik të prodhuesve të djathit të dhisë. Kemi fituar shumë përvojë praktike prej aktiviteteve të organizuara nga Agropuka si trajnime, trajnime prej pronarëve, shkëmbim përvojash me anëtarët e tjerë të grupit.

Gjithashtu, Agropuka na siguron pajisjet dhe enët për ruajtjen dhe transportin e djathit.

Para 3 muajsh - tha Iliriana - AP na solli tek Qendra e Përpunimit në fermën tonë, dy teknologë të prodhimit të djathit nga Malësia e Madhe, zotërinjtë Prel e Gjovalin Hasani, të cilët vëzhguan nga afër të gjithë procesin teknologjik të prodhimit të djathit të dhisë në fermën tonë. Duke korrigjuar me 3 gradë celsius temperaturën e qumështit ata arritën të marrin 3 kg djathë më shumë me të njëjtën sasi qumështi. Po ta llogaritim nga 3kg në ditë për mbi 150 ditë që është sezoni në marrim tani rreth 500 kg djathë më shumë, ose afërsisht sa paga e një punonjësi për këtë periudhë. Dhe e gjitha kjo i dedikohet AP që na i solli këta teknologë në fermën tonë. Nuk thotë kot populli; “më mirë të dish se të kesh”



KOSOVË: GRATË MË TË GODITURA NGA VARFËRIA

Femrat japin një kontribut thelbësor për familjet, komunitetin dhe vendin. Në vendet në zhvillim si Kosova, gratë shpesh menaxhojnë aktivitete komplekse dhe praktikojnë strategji të shumta jetësore. Aktivitetet ditore të tyre zakonisht përfshijnë përpunimin dhe përgatitjen e ushqimit, kujdesin për anëtarët e familjes dhe shtëpisë; ndërsa në zonat rurale, aktivitetet e tyre përfshijnë rritjen e kulturave bujqësore për konsum familjar dhe kujdesin ndaj kafshëve. Në Kosovë 60% e popullsisë jeton në zonat rurale. Të dhënat tregojnë se varfëria mbizotëron në këto zona, për shkak të shumë arsyeve. Më shqetësuese është fakti se gratë janë të prekura më së shumti, dhe kanë pengesa më të mëdha për zhvillim. Kufizimet me të cilat këto gra përballen në përgjithësi janë shumë të zakonshme dhe të njëjta në viset rurale në Kosovë:

- "Gratë përballen me mundësi të limituara të punësimit; Raporti i ASK në tregun e punës të vitit 2014 tregon se 41% e grave janë të papunë, në krahasim me meshkujt rreth 30%. Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 12%, krahasuar me 41% për burrat. Kjo shkallë e lartë e papunësisë në mesin e grave rrjedh

nga kombinimi i pjesëmarrjes së ulët të femrave në tregun e punës dhe mundësi të limituara për punë.

- Pamundësia e qasjes në arsim; problemet e grave janë rënduar më tej nga mungesa e qasjes së tyre në reformat e edukimit, juridikut dhe pronësisë.
- Mentaliteti patriarkal mbizotëron në zonat e thella rurale dhe të lëna pas dore; në këto zona komunitetet ende besojnë se burrat sjellin të ardhurat në shtëpi, strehim dhe krijojnë kushte të cilat mundësojnë ekzistencën e familjes, ndërsa gratë të qëndrojnë në shtëpi, të pastrojnë dhe të kujdesen për familjen.
- Femrat nuk janë të përfaqësuara sa duhet në pozita udhëheqëse. Janë identifikuar disa lloje të kufizimeve të cilat e vështirësojnë pozitën e gruas dhe mundësinë për t'u njohur si udhëheqëse, si: perceptimet për gratë në udhëheqje, mungesa e qasjes në mundësitë e rrjeteve joformale, si dhe mungesa e vetë-respektit.

IKC-ja nëpërmjet projekteve dhe bashkëpunimit me komunat i ndihmon gratë rurale në zhvillimin e tyre, kështu që komunat Ferizaj, Shtime, Viti, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtërpç, Lipjan dhe Partesh janë mbështetur 16 organizata grash ku janë përfshirë 240 gra ku me ndihmë të edukimit dhe mbështetjes teknike është ndihmuar zhvillimi i tyre. Këto aktivitete kanë si objektiv pjesën e prodhimit të mjedrës, luleshtrydhes, manaferrave dhe pemishteve si dhe përpunimin siç janë reçelet e shtëpisë, petëve dhe petë për pite.



tyre, si dhe për gjendjen të qëndrueshme të shoqatës. Në Bosnjë dhe Hercegovinë me mbështetje teknike, financiare dhe këshillëdhënëse për Shoqatën «Buzëqeshje për gratë» të prodhojnë punë dore për We Effect, ndihmoi të organizohen në kooperativë me çka u ndihmuar përforsimi ekonomik i grave rurale.

Çfarë do të thotë të jesh grua rurale, cili është roli i saj, me cilat probleme dhe sfida përballen ajo në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni dhe në çfarë mënyrë institucionet në shtetet përkatëse përpiqen tu ndihmojnë. Në lidhje me këto pyetje katër organizata FFRM, IKC, AgriNet dhe Agropuka japim mendimin e tyre, i prezantojnë angazhimet e tyre nëpërmjet përvojave dhe shembujve të grave - fermere. ●



MAQEDONIA: EDUKIMI I PAMJAFTUESHËM DHE MARGJINALIZIMI I MADH

Pozita e pa lakmueshme e grave në mjediset rurale në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë plotësuese e përkeqësojnë shumë faktorë.

Edhe përkaj asaj që gratë rurale kanë shumë të përbashkëta me gratë e vendeve urbane, megjithatë dallimet ndërmjet banorëve të mjediseve rurale dhe urbane në Maqedoni përcaktohen nga distancat e mëdha të vendeve rurale nga qendra, dendësia e vogël e vendbanimit dhe ofertat e kufizuara të shërbimeve publike, të plotësuara me mentalitetin patriarkal dhe konservator i cili sundon ende në mjediset rurale. Mungesat që rezultojnë nga jeta rurale u ndikojnë grave të mjediseve rurale në mënyra të ndryshme nga ndikimi që ato e kanë mbi burrat e mjediseve rurale dhe që lidhen me veçoritë siç janë: Qasje e kufizuar drejt transportit publik, fakti që shumica e grave bëjnë pjesë në grupmoshat më të moshuara, vështirësi për të depërtuar në tregun e fuqisë së punës, edukim i pa mjaftueshëm, obligime shumë të mëdha rreth familjes dhe kujdes ndaj anëtarëve të familjes, mungesa e shfrytëzimit efektiv të të drejtave të tyre, raporte familjare patriarkale, mos paraqitja e tyre relative në shumicën e programeve bujqësore dhe për zhvillim rural dhe përfaqësimi i tyre i pa mjaftueshëm në proceset e vendimmarrjes.

Pikërisht për ndihmë dhe zhvillim të gruas rurale Federata e Fermerëve të RM-së, që nga viti 2005 e formoi Rrjetin e grave rurale, qëllimi kryesor i së cilës është përforsimi ekonomik i gruas fermere, rritja e vetëdijes te gratë fermere për përfshirjen e tyre më të madhe në krijimin e politikës bujqësore, përhapjen rajonale të RGR dhe promovimi i saj dhe integrimi i çështjeve gjinore në sektorin bujqësor, si dhe nxitje dhe mbështetje e grave - sipërmarrëse. Çdo vjet FFRM-së së bashku me Rrjetin për zhvillim rural e organizon manifestimin - Dita ndërkombëtare e gruas rurale - 15 tetor, qëllimi i së cilës është të theksohet rëndësia e gruas - fermer dhe të nxitet veprimi i saj aktiv në krijimin e politikës bujqësore dhe shoqërimit bujqësor.

Sipas grave fermere është me rëndësi të forcohet sektori jo qeveritar që të mundësohet zhvillim dhe forcim ekonomik i gruas rurale. FFRM-së nëpërmjet projektit të cilin e implementon me We Effect, formon edhe fokus grup në fshatin e Shtipit Mustafino, që përbëhet nga 10 fermerë të vegjël të varfër prej të cilëve 8 janë gra - fermer. Ata nëpërmjet kooperativës Eko linden prodhojnë perime organike dhe gliko prej karotave. Pikërisht ky aktivitet do të tregojë se të bashkuar me punë të përbashkët mund të arrihet plasman i garantuar, grumbullim dhe profit më i madh, që ende nuk është praktikë e bujqve dhe mundësohet forcimi ekonomik i gruas rurale.

Vase Mojsovska me familjen e

sak në Fshatin Timjanik të Negotinës, prodhojnë rrush dhe llohe të ndryshme të fidanëve të pemëve. Ajo dhe bashkëshorti i saj e formuan firmën Agrokalem për prodhimin e fidanëve. Në mënyrë që ta arrijnë të gjithë këtë kanë kaluar rrugë të mundimshme dhe tani Mojsovski përvojën e tyre dhe ndihmën e tyre ua japin grave fermere, për zhvillimin e tyre.

«Unë jam grua - fermere dhe po, unë jam grua që vij nga mjedis rural, por unë jam krenare me atë që jam fermere dhe që e punoj profesionin më fisnik që ekziston prodhimi i ushqimit. Fëmijëria dhe jeta ime e deritanishme e kaluar nëpër arra për mua paraqet një luftë për jetë, por edhe gëzim kur prodhon prodhim bujqësor dhe kur e merr në dorë dhe e di se është fryt i punës tënde dhe vullnetit tënd për punë. Sepse, ndjenja nuk mund të përshkruhet kur e di se ti je ai që prodhon ushqim, ndërsa ushqimi do të thotë jetë, jeta do të thotë bekim. Gruan fermere, mund ta gjesësh nëpër arat në traktor, në shtëpi, në kuzhinë afër fëmijëve afër familjes afër mikeshave dhe çdo herë të jetë e gatshme për çdo rast, ndërsa më besoni vështirë dikush mund ta bëjë të gjithë këtë. Prandaj, ne kemi më ndryshe nga të tjerat dhe prandaj me forcat tona të përbashkëta do të punojmë për edukim të mëtejshëm dhe shoqërimin tonë që në mënyrë dinjitoze të fitojmë të drejtat tona dhe në mënyrë të barabartë të pozicionohemi me strukturat të tjera shoqërore», thotë Mojsovska.



35.000 euro për prodhim të çipsit prej molle

Cipsi i mollës prodhohet nëpërmjet proceseve të thjeshta të prerjes dhe tharjes së mollëve dhe më shpesh bëhet për konzervansë dhe shtesa të tjera, përveç erëzave si kanella, vanilja etj. Si prodhim është përqendrim i materieve të dobishme dhe të shëndetshme të mollës në version të thatë dhe në paketime më të vogla (100 g.). Nëpërmjet procesit të tharjes (dehidrimit) molla e humb vetëm ujin, por i mban të gjitha materiet e tjera ushqyese siç janë karbohidratet, pektinat, fibrat e celulozës, kaliumin, vitaminat (A, B dhe C) si edhe acidet organike (të mollës, limonit, të milingonës dhe të karbonit). Çipsi prej molle është konzervim i mollës në rrugë natyrore, në proces i cili i zvogëlon vlerat ushqyese. Duke pasur parasysh vlerën e tij ushqyese, ai përdoret për të gjitha moshat. Në tregun vendas deri më tani ka vetëm një prodhues, Nutrigrup me brndin Primo, kurse të pranishëm janë edhe prodhues të huaj, më shpesh nga shtetet fqinje.

Çips molle – proces prodhues dhe investim

Investimi kapital për prodhimin e çipsit të mollës është rreth 15.000 euro, prej këtyre investim më i madh, 75% pothuajse janë për tharësen (200 kg/mbushje) e cila ka vlerë prej 10 000 eurosh së bashku me kaldajën me ujë të ngrohtë që punon në dru/peleta dhe pajisjen shoqëruese.

- Kapaciteti i repartit të prodhimit të çipsit prej molle është i dimensionuar për prodhim të gatshëm prej 5 kilogramësh për një orë, përkatësisht 40 kg prodhim të gatshëm për orar pune prej 8 orësh, apo për një turn. Domethënë, kapaciteti i tharëses e përcakton edhe kapacitetin e repartit.
- Procesi i prodhimit është i thjeshtë dhe përfshin: seleksionim të mollëve për çips, që duhet të jenë me cilësi më të mirë, me aromë dhe shije të këndshme, të shëndetshme dhe të padëmtuara, pavarësisht nga forma e mollës, përgatitje të mollëve, larje dhe prerje e cila mund të jetë në formë të ndryshme; aromatizim, vanilje, kanellë apo ndonjë shije tjetër nëse nevojitet; tharje, dy mbushje në turne prej 8 orësh me nga 200 kilogram mollë, përkatësisht 40 kilogram prodhim të gatshëm, ose 80 kg në dy turne. Paketimi në sasi të ndryshme varet nga grupi i konsumatorëve të cilët janë grup qëllimor.



Prodhimi, çmimet dhe të hyrat

Pragu i rentabilitetit është rreth 4.000 kilogram çips në vit dhe pritet të arrihet në vitin e dytë dhe të tejkalohet në vitin e tretë.

- Prodhiimi i planifikuar në vitin e tretë është paraparë të jetë 5 tonë çips, ose rreth 20% e potencialit të paraparë të tregut.
- Është e rëndësishme të theksohet se tregu dhe shitja mund të jenë edhe më të mëdhenj, nëse gjendet mënyrë që të komunikohet vlera e prodhimit me publikun dhe nëse investohet në edukimin e konsumatorëve.
- Çmimi me shumicë është projektuar të jetë 45 denarë për 100 gr. paketim, kurse shitja me pakicë pritet të jetë rreth 50-55 denarë, me 5% TVSh dhe rreth 10% margjinë tregtare.
- Çmimi me shumicë i paketimeve të mëdha prej 1 kg është projektuar të jetë 250 denarë, kurse shitja me pakicë arrin rreth 290 denarë.

Të hyrat priten të arrijnë nivel prej rreth 2,2 milionë denarësh në vitin e tretë ose rreth 35.000 eurosh.



Potenciali për fitim

Viti i dytë, kur arrihet edhe pragu i rentabiliteti, shpenzimet fikse arrijnë 60% të shpenzimeve prodhuese të drejtpërdrejta të cilat me ekonominë në sasi zvogëlohen në 56% në vitin e tretë.

Shpenzimet e shitjes dhe menaxhmentit, të cilat janë relativisht fikse dhe arrijnë rreth 8.000 euro në vit, zvogëlohen si përqindje e të hyrave prej 40% në vitin e parë, prej 35% në vitin e dytë dhe 26% në vitin e tretë. Fitimi në nivel bruto zmadhohet nga 42% deri në 50% nga viti i dytë në të tretin, kurse në nivel operativ përmirësohet prej 11% në 24%.

Në shumë absolute, fitimi operativ në vitin e tretë arrin mbi gjysmë milion denarë ose rreth 8.500. Fitimi neto në vitin tretë, pas pagesës së kamatave, depreciacionit dhe tatimet është 6.000 euro. Kjo flet për një potencial impresionues të çipsit prej mollëve të thara.

Investim kapital	Numri i sasisë	Shuma	
Kade për larje	1	500	euro
Prerëse çipsi (gjysmë automatike)	1	1000	euro
Tharëse	1	10 000	euro
Paketim	1	1000	euro
Instalim i elementëve shoqërues		500	euro
Instalim elektrik		500	euro
Transport		500	euro
Përgatitja dhe përshtatja e objektit		500	euro
Investimi vjetor për mirëmbajtje		1000	euro
Investimi i përgjithshëm		15 000	euro

Vite		1	2	3
Parametra të të hyrave dhe shpenzimeve	Shuma	mkd/kg	mkd/kg	mkd/kg
Të hyra		413,3den	425,7den	438,5 den
Çmimi shitës për 100g	45 den			
Çmimi shitës për 1kg	250 den			
Të drejtpërdrejta		285.7 den	243.7 den	219.6 den
Vlera e furnizimit me mollë	6 den	60.0 den	61.8 den	63.7 den
Shpenzimi për ambalazhim		19.6 den	20.8 den	20.8 den
Shpenzimi për energjinë		11.7 den	11.7 den	11.7 den
Paga mujore bruto operativa		80.0 den	61.8 den	50.9 den
Shpenzime të përgjithshme për prodhimin		114,6 den	88,4 den	72.7 den
Fitimi bruto për kg		127,5 den	181.9 den	218.7 den
Margjina bruto e fitimit		30,80%	42,70%	49,90%
Shitja, administrimi dhe menaxhime		114,20%	114,20%	114,20%
Fitimi operativ për kg		40.1 den 47.9 den	134.6 den	104.6 den
Margjina opertaive e fitimit		9,70%	12,20%	23,80%

Prodhiimi/viti	1	2	3
Shkalla vjetore e rritjes		33%	25%
Prodhiimi i çipsit prej molle (kg)	3000	4000	5000
Paketimi prej 100	90%	90%	90%
Paketimi prej 1kg	10%	10%	10%
Sasia 100g(kg)	2700	3600	4500
Sasia 1kg(kg)	300	400	500
Llogaritja e të hyrave/Viti	1	2	3
Sasia e prodhuar e çipsit (kg)	3000	4000	5000
Sasia 100g (kg)	2700	3600	4500
Sasia 1kg (kg)	300	400	500
Sasia 100g (paketimi)	27000	36000	45000
Sasia 1kg (paketimi)	300	400	500
Çmimi i shitjes për 100g (mkd)	45.0 den	46.4 den	47,7 den
Çmimi i shitjes për 1kg (mkd)	250.0 den	257.5 den	265.2den
Të hyrat 100g	1215000 den	1668 000 den	2148323 den
Të hyrat 1kg	25000 den	34333 den	44204 den
Të hyrat nga shitja me shumicë	1240000 den	1702933 den	2192527 den
Të hyrat nga shitja me shumicë (euro	20163 eur	27690 eur	35651eur

Teksti është pjesë e një studimi fizibiliteti mbi mollën i iniciuar nga Qendra për Zhvillim të Rajonit Malor të Pellagonisë, me mbështetje të Projektit për mbështetje të bizneseve të vogla, i financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky aktivitet është pjesë e kornizës së Projektit për vendosje dhe zbatimin e qasjes EU LIDER LAG.

Shkruan: Vladimir Millanoviq

BORONICA SIBERIANE edhe tek ne

Mejberi (Honey Berry) është bimë unike gjetherënëse me fruta të ëmbla dhe të shijshme. Bima lulëzon në mars, kurse lulet janë të vogla, të bardha dhe me aromë dhe mund të durojnë deri në -7°C . Frutat piqen në maj dhe kanë ngjyrë të kaltër me shtrësë dylli, formë trekëndore me gjatësi 2 cm, kurse tuli është me ngjyrë të kuqe me farë si të kivi. Shija mund të jetë e thartë, pak e ëmbël ose e hidhur. Mund të konsumohet si frutë e freskët ose në pita dhe biskota, xhem, lëng frutash dhe jogurt. Kanë veti shëruese për shkak të karakteristikave të veta antioksiduese dhe përqendrimit të lartë të vitaminës C dhe D. Familja e boronicave të majit përbëhet nga 200 lloje shkurresh dhe bimësh zvarritëse dhe të gjitha pothuajse përdoren si bimë zbukuruese. Kjo bimë frutdhënëse është e llojit shumë rezistent, shkurre e vogël me prejardhje nga Siberia Lindore, nga lindja e largët ruse, nga Japonia, ku njerëzit i kanë mbledhur prej kohësh dhe i kanë konsumuar në sasi të mëdha. Boronica e majit vlerësohet veçanërisht për shkak të frutës së shijshme – bobinës dhe pjekjes shumë të hershme, minimum 2 javë para luleshtrydheve. Karakterizohet me rezistencë të përkryer, duron të ftohtë deri në -40°C .





PLLENIMI: kur është vetë nuk është pjellore. Nevojiten minimum dy bimë dhe ato më mirë të jenë të llojeve të ndryshme.

PRODHIMI: në vitin e parë ose të dytë pas mbjelljes. Rendimenti është 3-5 kg për bimë.

DËMTUES DHE SËMUNDJE: nuk është vënë re sulm prej sëmundjeve apo insekteve, prandaj rekomandohet për kultivim EKO. Kjo bimë i tërheq zogjtë dhe prandaj është e rekomandueshme mbrojtja në maj si edhe më vonë për shkak të farave.

KRASITJA: heqja e degëve të thata apo krasitje rekomandohet në 3 deri në 5 vitet e para të pas mbjelljes. Pastaj, në çdo 2 ose 3 vjet në pranverën e hershme, para se të fillojë vegjetacioni, të hiqen me patjetër degët e thyera dhe të holla.

Boronica e majit nuk i përzgjedh tokën dhe klimën. Tokat me lagështi janë treguar si më të mirat, qofshin ato natyrore qofshin ato me ujitje. Gjithsesi nuk do të mbijetojë në rajone me tepër lagështi ku ujërat nëntokësore janë në sipërfaqe për një periudhë më të gjatë kohore. Si dhe shumica e frutave dhe bimëve të familjes së luleshtrydheve kërkojnë terrene me pasqyrim të mirë drejt dritës. Në Luginën Willamette (vendbanim natyror) dhe në rajonet e tjera ku vera është relativisht e ngrohtë, rekomandohet hije e pjesshme.

Bimët mund të vendosen 1 deri në 2 metro larg. Për mirëmbajtje të lagështisë së nevojshme të tokës është e dobishme, hedhja e përzierjeve të plehrave, mushk apo materialet e tjera të ngjashme. Kërkon ujitje të rregullt gjatë periudhave të thata, kurse në ujë të shtohet edhe plehu Italtollina. Për një zhvillim të shëndetshëm dhe të fuqishëm të përdoret 1-2 litra humus "kaline" ose pleh organik Italtollina në vjeshtë dhe në pranverën e hershme. Vlera pH optimale është 5,5-6,5, por mund të kultivohet edhe me vlerë pH 3,9-7,7. ●



Kombajnë për mbledhjen e domateve



Shkruan: Prof. Dr. Dragi Tanevski

Fakulteti për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim - Shkup

Mbledhja e domateve me mekanizim është zhvilluar më shpejtë në Kaliforni për tri shkaqe kryesore: kushtet e volitshme klimatike, mungesa e dorës së punës dhe llojeve përkatëse. Edhe pse mekanizimi ka bërë përparimin më të madh në drejtim të realizimit të prodhimit industrial të domateve, megjithatë faktor kryesor është seleksionimi dhe gjetja e llojeve përkatëse për atë teknologji.

Mbasi të konstatohet pjekuria prej 50%, bëhen disa testime për pjekurinë e frytit dhe mbasi pjekuria të arrijë 60 - 70%, ky është momenti më i përshtatshëm për fillimin e mbledhjes me mekanizim të domateve me kombajnë. Mbledhja më e madhe arrihet kur pjekuria e domates arrin 80 - 90%. Nëse pritet pjekuria e plotë prej 100% në kulmin e mbledhjes intensive pjesa më e madhe e domateve janë tepër të pjekura.

Llojet e domateve për mbledhje me

mekanizim dihet t'i kenë këto veçori:

- fryti të jetë i fortë sa duhet, të durojë mbledhjen me mekanizim dhe transportin e gjatë,
- kërcelli të jetë i ulët me lartësi të barabartë,
- frutat të pihen për kohë relativisht të shkurtë dhe në mënyrë sa më të barabartë, t'u rezistojnë sëmundjeve lokale,
- frutat të ndahen lehtë nga degët,
- frutat të jenë rezistuese ndaj pëlcitjes dhe frutat e pjekur të qëndrojnë në gjende të pjekur për një kohë sa më të gjatë.

Në republikën tonë, linja e makinave amerikane (FMC) përdoret nga shtatori i vitit 1973 në "Ovçe Pole" nga Sveti Nikolla, ndërsa linja hungareze e makinave përdoret që nga viti 1976 në „Cërvena Xvezda" nga Shtipi.

Të gjitha llojet e kombajnave për mbledhjen e domateve punojnë sipas parimit të njëjtë themelor – në një përshtatje. Prihen bimë të tëra, ndërsa frutat shkulen në mënyrë mekanike në kombajnë e njëjtë dhe në bazë të shkurdjes së komplikuar.

Frutat e këputur lëvizin nëpër pajisjet për transport, ku me dorë grumbullohen frutat jeshile, frutat më të pjekura dhe të dëmtuara, ndërsa frutat cilësore ngarkohen në sënduk për transport. Sot grumbullimi bëhet edhe më seleksionues elektronik pneumatik, gjatë kësaj kursehet dora e punës deri në 75% ndërsa dukshëm

rritet edhe aftësia e lëshimit të kombajnës.

Kombajnat për mbledhjen e domateve mund të jenë me tërheqje ose që lëvizin vetë. Parimi i punës të të gjitha kombajnave që prodhohen është i njëjtë. Organet e punës marrin fuqi nga motori, ndërkaj forcë bartet nga pompat hidraulike deri të motorët hidraulik të instaluar për çdo organ pune. Kombajnat lëvizin nën ndikimin e fuqisë së motorit të tyre nëpërmjet variatorit të transmisionit. Organet themelore të punës prej të cilave përbëhet një kombajnë për mbledhjen e domateve janë:

- Pajisja për prerje dhe mbledhje të bimëve nga domatet,
- Pajisja që ndan dheun
- Pajisja që ndan frutat dhe
- Pajisja për seleksionimin e frutave sipas shkallës së pjekurisë.

Pajisje për prerje dhe mbledhje të bimëve nga domatet. Te kombajnat për mbledhjen e domateve përdoren pajisje të ndryshme për prerjen dhe mbledhjen e frutave. Te numër i madh i kombajnave, pajisja për prerje përbëhet nga dy disqe metalike të cilat kanë drejtim të kundërt të lëvizjes. Me ndihmën e këtyre disqeve prihen kërcëjtë në sipërfaqen e tokës, të mbjella në dy rreshta të një leje. Disqet përputhen me sipërfaqe të caktuar, me çka me sukses presin kërcëjtë në afërsi të rrënjës (prej 2 deri në 5 cm).



Kombajnë vetëlëvizëse për mbledhjen e domateve

Pajisje që ndan dheun. Kjo pajisje gjendet te ato kombajna për mbledhjen e domateve të cilat kanë disk pajisje për prerje ose me kosë. Ndarja e dheut mund të kryhet në më tepër mënyra. Një nga mënyrat është transportuesi letviçest i cili përbëhet nga dy pjesë midis të cilave kalojnë bucat e dheut. Ekzistojnë zgjidhje ku ndërmjet dy transportuesve vendoset rrotë në formë ylli ose me më tepër cilindra, nëpërmjet të të cilave kalojnë kërcejtë me fruta, ndërsa ndahet dheu dhe pjesë e caktuar e frutave të cilët nuk janë mirë të kapura për degët.

Pajisje që ndan frutat. Pajisja që ndan frutat ka për detyrë t'i ndajë frutat nga trugu i domateve. Ekzistojnë më tepër konstruksione. Kjo pajisje përdor bashkëveprimin respektivisht përshpejtimin e masës së frutave. Masa e frytit e cila ndodhet e përforcuar për trugu duhet të përshpejtohet aq shumë sa që dallimi ndërmjet fuqisë së bashkëveprimit dhe forca me të cilën mbahet fryti për trugu të jetë më e vogël se zero.

Pajisje për seleksionimin e frutave sipas shkallës së pjekurisë. Për shkak se mbledhja e domateve me mekanizim varet nga fuqia e punës, në shtet e zhvilluara ku fuqia e punës është mjaft e shtrenjtë, një kohë të gjatë punohet në drejtim të mekanizimit të mbledhjes. Në këtë drejtim në vitin 1972 në ShBA, filloi puna e seleksionuesit e automatizuar, ndërsa në vitin 1975 filloi të zbatohet në prodhimtari seleksionuesi AMF i cili është paraqitur në dy versione, me pajisje pneumatike dhe mekanike për ndarjen e frutave jeshile dhe sendeve të tjera. ●



Kombajnë për mbledhjen e domateve ("Ovçe Pole" - Shën Nikollë)



Kombajnë vetëlëvizëse për mbledhjen e domateve



Kombajnë për mbledhjen e domateve ("Ovçe Pole" - Shën Nikollë)



Pajisje për transportimin e domates



Pajisje për prerjen e trugjeve të domates

Si të fitojmë më shumë mjaltë

Shkruan: **Rade Karanfillovski**
- "Apicentar" - Manastir

Tani më është korrik, ndërsa kosheret janë të zbrazura, jo vetëm në hojet por edhe në shtrat. Që ta zbutim këtë gjendje, do të përqijem të shkruaj diçka në lidhje me atë se si të përmirësojmë mbledhjen e mjaltit, gjegjësisht të përkujtohem në disa punë të cilat ndoshta i kemi harruar. Përmirësimi i këtyllë është akoma më i vlefshëm, gjithsesi, kur kushtet klimatike janë më të mira për mbledhjen e mjaltit.

1. Kullota - është faktori kryesor nga i cili varet jeta dhe zhvillimi i familjes së bletëve. Karakteri i kullotës përcaktohet nga karakteri i përbërja e florës. Disa bimë tajisin shumë nektar, ndërsa të tjera më pak. Ato që tajisin shumë nektar i quajmë kullosa kryesore. Të këtylla janë akaciet, rrepat vajdhënese, luledielli etj. Bimët të cilat tajisin më pak nektar e formojnë kullosën mbështetëse. Sado më pak nektar të tajisin, ato e mbështetin kondicionin e shoqërisë. Dhe, në bazë të kësaj, janë me rëndësi të jashtëzakonshme.
2. Teknologjia e kujdesit për bletët - ajo çdo herë duhet të jetë e harmonizuar me kullosën kryesore. Zhvillimi intensiv i familjes së bletëve duhet të fillojë 51 ditë para fillimit të kullosës kryesore dhe të përfundojë 35 ditë para fundit të kullosës. Kjo do të thotë, bletët nga të gjitha vezët r lëshuara, të marrin pjesë në kullosën kryesore.
3. Lloji i koshereve - koshere lanstrotove dhe fororav, janë më të mira për grumbullimin e mjaltit sepse janë më të mira për kombinim (më mirë mund të punohen) krahasuar me DB e cila është më inerte. Kur flasim për kosheret, mund të tregojmë edhe një proverb popullore: "Çdo pushkë është më e mirë në duart e heroit të mirë". Lloje të ndryshme të koshereve kërkojnë teknika të ndryshme të përpunimit bletar.
4. Kushtet meteorologjike - ato duhet të jenë të mira. Bletari nuk mund të ndikojë mbi to, ndërsa kohën e fundit, me ngrohjen globale, kushtet klimatike u bënë shumë të pa parashikueshme. Për rendiment të mirë të mjaltit, në rrethinë sigurisht duhet të ketë bimë të mira për prodhimin e mjaltit. Shpesh herë, në kushte të këtylla, nga dy koshere në dukje nga familje të bletëve të ngjashme, fitojmë rendiment të ndryshëm. Blegtori këtu mund të ndikojë nëse për shkak të bimëve që gjatë një periudhe të caktuar do të japë nektar më të mirë gjegjësisht do ta vazhdojë mbledhjen e mjaltit me ujitje dhe mbjelljen e kulturave më shumë herë.
5. Kohëzgjatja e tajitjes së nektarit - vazhdimi i kohës së lulëzimit, respektivisht tajitjes së nektarit, varet edhe nga lloji i bimës dhe nga pllenimi. Tajitja e nektarit përfundon menjëherë sapo të pllenohet lulja. Kjo tregon se tajitja e nektarit do të vazhdojë më gjatë nëse ka më pak bletë në rajon. Koha me erë, gjithashtu,



i pllenon bimët dhe e shkurton kohën e tajitjes së nektarit. Në rajonet në të cilat ka tajitje të dobët të nektarit, gjithashtu, duhet të ketë edhe më pak bletë.

6. Largësia nga kullosat p kjo është me rëndësi të madhe sepse bëhet fjalë për shpenzime transporti për bletët. Sa më larg janë kullosat, aq më të mëdha janë shpenzimet për transport (shpenzim i mjaltit). Mjalti shërben si karburant. Mjalti përveç që shpenzohet për të shkuar deri te kullosat dhe për kthim, ai është i nevojshëm edhe gjatë thithjes (fluturimit nga lulja në lule). Kullosat më të gjata se 2,5 km janë jo rentabile, respektivisht më shumë do të shpenzohet sesa që do të grumbullohet. Bletët, zakonisht i shfrytëzojnë kullosat deri në 800 metra të cilat janë më rentabile. Më mirë është nëse bletët çohen deri te kullosat. Këtu vlen edhe proverbi: "Mjalti lindet në rrota". Këtu bëjnë pjesë edhe shpenzimet për transport për mbledhjen e polenit dhe propolisit. Uji, gjithashtu, duhet të jetë sa më afër.
7. Rasa dhe bletët meleze janë me rëndësi të madhe për mbledhjen e nektarit. Bletët meleze kanë aftësi të kufizuar për Mbledhjen e nektarit. Më shumë mbledhin bletët autoktone të atij rajoni.
8. Fuqia e familjes së bletëve - e përcakton numrin e bletëve në familje. Numri i bletëve në një familje varet nga cilësia e mbretëreshës (madhësia e saj) dhe e vezës të saj. Për shoqëri të mirë mbretëresha duhet të lëshojë 1500 deri në 3000 vezë për një ditë - natë. Bletari produktive me shumë mbretëresha me cilësi të keqe nuk mund të mbijetojë. Mbretëreshat e mira me vezët e tyre e zhvillojnë familjen deri në maksimum. Tani do ta citoj blegtorin e njohur amerikan Dulitl, i cili ka thënë: "Më jepni mbretëreshë të mirë, ndërsa unë do Tu bëj shumë mjaltë".
9. Ndikimi i shtratit - për grumbullim më të mirë të mjaltit duhet të ketë shtrat sa më pak të hapur, ndërsa sa më shumë shtretër para daljes së bletëve dhe shumë bletë të vogla.
10. Raporti ndërmjet bletëve mbledhëse dhe pranuese të nektarit - kjo është me rëndësi të madhe për grumbullimin e mjaltit. Bletët mbledhëse janë ato të cilat fluturojnë për të mbledhur nektar dhe e çojnë te kosherja ndërsa bletët pranuese e pranojnë mjaltin nga bletët që e mbledhin. Bletët që e pranojnë

janë rreth 45 - 50%, ndërsa mbledhëset 55 - 60%. Një bletë mbledhëse në koshere i takojnë 2-6 pranuese të cilat e pranojnë nektarin, i shtojnë enzimë dhe e ventilojnë që të reduktohet uji në 17 - 22%. Shpesh herë gjatë kullosave kryesore një pjesë e bletëve pranuese hyjnë te bletët mbledhëse dhe e rrisin numrin në 60 - 70%. Mbledhëset e mbledhin polenin.

11. Sigurimi me ushqim - për punën e mirë të familjes së bletëve dhe inspektimin e vitalitetit të bletëve të cilat do të rrisin grumbullimin e mjaltit nevojitet ushqim i mjaftueshëm gjatë dimrit, ndërsa kjo do të thotë 16 - 20 kg mjaltë. Nëse rezervat me ushqim janë të vogla, dalin bletë të reja të vogla dhe jo cilësore.
12. Cilësia e ushqimit - për ushqimin gjatë dimrit nevojitet mjalti të mos jetë i pyjeve ose me sheqer. Ushqimi i keq rezulton me rendiment të ulët të mjaltit.
13. Pluhuri i luleve - vëllimi i tij është shumë i rëndësishëm për krijimin e bletëve cilësore të cilat janë mjaftë të mëdha dhe me jetëgjatësi më gjatë. Jetëgjatësia e tyre është mjaft e rëndësishme. Imagjinoni familje me gjashtëdhjetë mijë bletë të cilave ua kemi vazhduar jetën për 1 ditë. Kjo do të thotë se kemi fituar gjashtëdhjetë mijë ditë pune të bletëve, tepëricë.
14. Bletaria është produktive, kur nuk është cenuar raporti ndërmjet bletëve që mbledhin nektar dhe bletët që pranojnë nektar nga njëra anë dhe ushqyeseve të shtratit nga ana tjetër. Numri i madh i ushqyeseve - dado të shtretërve e bën familjen e bletëve jo produktive.

Bletarët duhet në mënyrë më të detajuar ti lexojnë dhe ti praktikojnë çështjet e lartë përmendura. Respektimi i tyre do tua bëjë bletarinë më produktive. Të gjitha elementët janë të rëndësishëm, por megjithatë, njëri është më i rëndësishëm, dhe kjo është kullosa dhe shfrytëzimi i saj. Do të kisha përmendur se gjatë zgjedhjes së vendit për bletari, çdo herë duhet mirë të analizohet sa rriten bimët në atë teren dhe mundësitë për përmirësimin e tajitjes së nektarit. Blegtorët të cilët bletët e tyre i huazojnë për pllenim, duhet një pjesë të këtyre kushteve ti kërkojnë nga pronari i kulturave të cilat pllenohen ndër të cilat edhe për ujitje dhe rrugë të mira të qasshme deri te mjedisi ku rriten kulturat. Të përkufizohet nevoja për herbicide dhe pesticide derisa bletarët janë në teren dhe disa kohë para kësaj, në varësi të periudhës së tërheqjes së mjeteve për mbrojtje. ●

Demonstrim praktik i vjeljes dhe paketimit të rrushit të tryezës

Vjelje dhe magazinim i rregullt rrushit të tryezës është një prej aktiviteteve më të rëndësishme mbi të cilat duhet të kenë kujdes fermerët. Pikërisht këto rregulla të vjeljes Federata e Fermerëve të RM-së nëpërmjet Rrjetit të grave fermere organizoi vjelje dhe magazinim praktik të rrushit të tryezës të llojit "strashinski". Aktiviteti u realizua në fshatin nga Negotina, Pepelishte në vreshtin e kompanisë bujqësore "Agro kalem" që është në pronë të Vase dhe Goce Mojsovska. Pikërisht dhe vetë iniciativa është e Vase Mojsovska e cila thekson se vjelja e rrushit të tryezës është shumë e rëndësishme se si kryhet vjelja. Ajo prezantoi vjelje të "strashinski" në pemishten prej 1 ha të mbjellë me këtë lloj.

"Ne me të njëjtin lloj kemi mbjellë 4 hektarë që gjenden në një lokacion tjetër. E rëndësishme për rrushin është prerja me gërrshërë vreshti prej kërcellit, heqja e kokrrave lila të cilat janë të papjekura dhe vendosja e rregullt, të vendoset bukur në arkë", tregoi praktikisht Vase Mojsovska. Ata shembullin e mbjelljes dhe kultivimit të drejtë të rrushit të tryezës ata e kanë parë në Itali nëpërmjet shembujve praktikë, kurse mandej e zbatuan vetë edhe te ne. Ka disa lloje paketimi të rrushit të tryezës, por Mojsovska prezantuan mënyrën standarde të paketimit. Në vetë takimin, gratë - fermerët të cilët janë kryesisht kultivues të frutave së bashku duke ndjekur shembullin e Mojsovska me ndihmën e grave fermere të trajnuar për të vjelje të rregullt, e realizuan vjeljen dhe paketimin e rrushit, i cili nga kopshti i Mojsovska do të transportohen në tregun rus.

Çmimi i rrushit të tryezës me cilësi të shkëlqyer për këtë vit është nga 20 deri në 27 denarë për kilogram dhe është shumë më i mirë se i rrushit të verës, për të cilin gjithashtu kushtet e favorshme klimatike kanë ndihmuar të jetë me cilësi të shkëlqyer.

Aktiviteti i FFRM-së është realizuar në kuadër të projektit «Mbështetja institucionale e FFRM-së», mbështetur nga We Effect. ●



Mbështetja teknike e kooperativave të cilat përgatisin plane biznesi

Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë në kuadër të projektit «Mbështetja institucionale e FFRM-së», i cili është zbatuar me We Effect dhe në bashkëpunim me Asociacionin Maqedonas të Kooperativave në fund të gushtit ka kryer vizita në terren në tri kooperativave të suksesshme që përgatisin planet e biznesit për zgjidhjen e problemeve aktuale për punë më të suksesshme dhe që do të prezantojnë në punëtorinë e fundit edukative për kooperativat që FFRM-

ja do ta realizojë në muajin nëntor. Planet e biznesit të kooperativave bujqësore «Agrobogdanci», «Eco Ilin-den» dhe «Eco Fasulj» për ndërtimin e kalemareve, për furnizim me mekanizmin e përshtatshme bujqësor, si dhe makinerinë për peleta ose për mbledhje të fasuleve janë në fazën e fundit. Nga fundi i shtatorit FFRM-ja planifikon përsëri të bëjë vizitë në 3 kooperativave në Manastir, Ohër dhe Kriva Pallankë, të cilat gjithashtu përgatisin planet e biznesit. ●





Mbledhja vjetore e Rrjetit të Grave Fermere

Rrjeti i Grave Fermere (RrGF) që është pjesë e Federatës së Fermerëve të Republikës së Maqedonisë e mbajti Mbledhjen vjetore ku u diskutua mbi aktivitetet e realizuara si dhe mbi propozimet për realizimin e aktiviteteve të ardhme, të cilat janë pjesë e strategjisë së funksionimit të RrGF-së për involvim më të madh të grave në zhvillimin e bujqësisë. Balancimi i përfaqësimit gjinor në sektorin e bujqësisë duhet të jetë prioritet i politikës për çdo Qeveri të shteteve të cilat kanë një numër të theksuar të njerëzve të cilët jetojnë në mjediset rurale.

Gjatë mbledhjes Koordinatorja kombëtare iu drejtua të ftuarave të pranishme me fjalimin e vet, kurse pas fjalimit u mbajt edhe prezantimi i aktiviteteve të RrGF dhe diskutim aktiv. "Në Mbledhjen vjetore të RrGF-së që mbahet çdo vit, u diskutua mbi realizimin e aktiviteteve dhe mbi propozimet për aktivitetet e ardhshme të RrGF-së. Vëmendje e veçantë iu kushtua sipërmarrjes së grave ku nëpërmjet tribuneve së bashku me Shoqatën e Grave Biznesmene i analizuan problemet e grave fermere në biznesin bujqësor. Në tribunë mori pjesë edhe Presidentja e Shoqatës Boshnjake të Grave Biznesmene, me çka na u mundësua shkëmbim interkulturor i informacioneve. Prej saj mësuam mbi problemet bu-



jqësore në Bosnjë dhe kuptuam se kemi shumë probleme të ngjashme. Takimet e tilla janë me rëndësi enorme për RrGF para së gjithash sepse janë pjesë e pazëvendësueshme e realizimit të strategjisë së FFRM-së e cila është prezantuar më parë. Përshtypje të madhe më la fakti se gratë morën pjesë aktivisht në diskutim dhe shkëmbyen shumë ide produktive dhe analiza të situatave momentale" – theksoi Lubica Coniq. Mbledhja vjetore e Rrjetit të Grave Fermere është pjesë e projektit "Mbështetja institucionale e FFRM-së" që është mbështetur nga Fondacioni Suedez We Effect.

Sipas menaxherit të projektit Biljana Petrovska-Mitrevska e projektit "Mbështetja institucionale e FFRM-së" aktivitetet e tilla mundësojnë shkëm-

bim më të madh të grave fermere në shoqatën e bujqve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në marrjen e qëndrimeve dhe luftën për realizimin e tyre.

"Gjatë këtij viti nëpërmjet projektit «Mbështetja institucionale e FFRM-së» organizon aktivitete për gratë -fermere me të cilat mundësohet edukimi i tyre, zhvillimi i aftësive të biznesit, si dhe ndërtimi i karakteristikave të tyre drejtuese. Do të veçoja këtu se fokus grupet me të cilat punohet me gratë fermerë, ku ato prodhojnë drejtpërdrejt dhe shesin, takimet edukative të shkëmbimit të përvojave të grave për gratë, si është trajnimi i vjeljes së rrushit të tryezës në vreshtin e Vase Mojsovska, vizita studimore e grave fermere nga Kosova dhe shoqërimi i karakterit human, përkatësisht realizimi i evenimentit tradicional i FFRM-së "Petkat", thotë Mitrevska.

Në suazat e takimit u mbajt tribuna me titullin "Roli i grave fermere në zhvillimin e sipërmarrjes", që u realizua në bashkëpunim me Shoqatën e Grave Biznesmene. Në këtë takim ka marrë pjesë dhe Presidentja Aida Zubeviq nga Shoqata e Grave Biznesmene nga Bosnja dhe Hercegovina, e cila dhe mbështetje dhe nxitje mbi zhvillimin e sipërmarrjes të grave fermere. ●



Demonstrimi i kultivimit të fasules së Tetovës në kallam

Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë në kuadër të projektit «Mbështetje institucionale e FFRM-së», që zbatohet nga We Effect ka kryer vazhdimisht vizita në terren në kooperativën bujqësore «Eko Fasul» nga fshati i Tetovës Kamjan e cila prodhon fasule në kallam. Të dy themeluesit bashkëkooperativistë të përkushtuar «Eko fasul» Afrim Ziberi dhe Memet Sinani kanë mbajtur një demonstrim se si ata kultivojnë fasule në kallam për kolegët e tyre - anëtarë të FFRM-së nga e gjithë Maqedonia. Qëllimi i këtij takimi edukativ është që prodhimi i fasule të përhapet më shpejt edhe në rajone të tjera të vendit tonë, për të cilin u interesuan mjaft edhe kalimtarët e zakonshëm të cilët i kanë vënë re të lashtat. Prodhimi i varieteteve të larta të fasuleve në kallam është shumë më i thjeshtë dhe më i dobishëm se sa kultivimi konvencional i kësaj kulture me misër.

Rendimente që kompani i pret në këtë mënyrë, në asnjë rast nuk mund të fitohet duke kultivuar fasulen me misër, domethënë prej një hektari planifikohet të merren 3-4 tonë fasule, kurse me kultivimin klasik të misrit, mund të fitohen vetëm nga 250 deri në 500 sasi për hektar. Bashkëkooperativistët

e «Eko fasul» kanë mbjellë gjithsej 30 dynym fasule tetove në kallam, që është nga fundi me procesin e brendimit. Bujqit nga rajoni i Tetovës shpenzojnë më tepër financa për pagimin e punëtorëve sezonalë për përpunimin e fasules, heqjen e barërave të këqija, prandaj është çmimi i lartë për këtë fasule në treg, e cila është e njohur për masën e kokrrës dhe cilësinë e saj. Prandaj kooperativa bujqë-

sore «Eko Fasul» në krye të së cilës është një grua e re dhe ambicioze, menaxherja, Eljesa Ziberi po përgatit plan biznesi për furnizim me mekanizim bujqësor për kultivim dhe mbledhje të fasules, i cili do ta bëjë më të shpejtë dhe më efikase punën e kultivimit dhe mbledhjes së fasuleve. Në prezantimin edukativ morën pjesë fermerë nga rajoni i Pellagonisë, Shtipit dhe Shkupit.



U organizuan rrethe studimore

IKC-ja në bashkëpunim me profesorë të Universitetit për Bujqësi në Prishtinë organizuan rrethe studimore dhe trajnime me organizata dhe fermerë nga fusha e ekonomisë bujqësore dhe bujqësia. Pikërisht në mënyrë të tillë praktike u këmbëngul që bujqit të marrin edukimin përkatës i cili do t'i ndihmojë në zhvillimin e tyre dhe në zhvillimin e prodhimit të tyre.

Prezantimi i rakisë vendase në panairin në Pukë

IKC-ja së bashku me fermerët e shoqërisë «Teqe» morën pjesë në panairin në Pukë (Republika e Shqipërisë) më 24 shtator, ku kooperativa i prezantoi prodhimet e kumbullave të thata dhe rakisë së bërë prej frutash nga pemëtoret e veta. Bashkëpunimi i tillë racional mundëson lidhje ekonomike të bujqve nga rajoni e cila është e domosdoshme për zhvillimin e bujqësisë, sidomos në pjesën e përmirësimit të prodhimit cilësor dhe të plasmanit. ●

Manifestimet bujqësore në panaire për një shitje më të mirë



Në muajin gusht IKC ka realizuar manifestim panair me qëllim që të ndihmoj bujqit që të promovojnë dhe të shesin prodhimet e veta.

Në fillim të gushtit 40 bujq me prodhimet e veta morën pjesë në panairin e bujqësisë që e organizoi IKC-ja në bashkëpunim me Komunën e Vitisë në fillim të gushtit. Në këtë panair si bujq të cilët i ekspozuan prodhimet e veta, gjithashtu, ishin edhe bujqit nga komunat e tjera: Shtimë, Ferizaj etj. Në këtë panair mori pjesë dhe zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë z. Vezir Jonuzi.

Gjithashtu në gusht IKC-ja në bashkëpunim me Komunën e Ferizajit në sheshin në Ferizaj organizoi "Panair rajonal për prodhime bujqësore". Në këtë eveniment tregëtor morën pjesë mbi 60 fermerë nga komunat rajonale (Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtimë, Viti, Lipjan, Terandë etj.). Duhet të përmendet se të dy panairët e organizuar ishin shumë të rëndësishëm, kurse rezultati i tyre ishte shitja e të gjitha prodhimeve bujqësore.

Në fillim të shtatorit IKC-ja në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit organizoi panair në qendrën e qytetit të Hanit të Elezit dhe në këtë panair morën pjesë bujq nga komunat përreth (Kaçanik, Viti etj.).



Organizohet takimi “PREPARE Gathering 2016” në fshatin Voskopojë Korçë, Shqipëri

Shkruan: Tomi Pikuli

Nga 13 - 16 shtator 2016, PREPARE (Partneriteti për Evropën Rural) organizoi në Voskopojë (fshati i Korçës) takimin e parë multikombëtar tematik në kuadër të programit ALTER, i përqendruar kryesisht në forcimin e organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Partnerët në projekt ALTER janë shoqëri civile të bazuara në Rrjetet e Zhvillimit Rural në Serbi (partneri kryesor), Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni (FYROM) Maltë Zi dhe Fondacioni për Zhvillim e Turqisë.

Bashkëpartnerët janë HMMR Rrjeti Kroat për Zhvillim Rural dhe Forumi Rural Letones, që përfaqësojnë PREPARE Partneritetin për Evropën Rural. Grupi i Ngritur i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal në Evropën Juglindore është një Ortak formal i projektit.

Fondacioni AgriNet Albania, si një nga iniciatorët dhe anëtar i bordit të ANRD (Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural), mori përgjegjësi në për të pritur dhe për të lehtësuar organizimin e aktivitetit dhe eventit në rajonin e Korçës.

Të paktën 70 pjesëmarrës nga 20 vende evropiane u bashkuan për mbledhjen, shkëmbimin dhe për të mësuar nga njëri-tjetri me një objektiv të përbashkët për të kontribuar në krijimin e rrjeteve për zhvillim të qëndrueshëm rural.

Temat kryesore që u diskutuan si në mënyrë të përmblendhur ishin: Forcimi i kapaciteteve të rrjeteve CSO's dhe CSO për të marrë pjesë në mënyrë aktive në planifikimin dhe zbatimin e politikave, për të ndërtuar një shoqëri të fortë civile në zonat rurale, dhe për të rritur zhvillimin rajonal përmes rrjeteve dhe bashkëpunimit.

Dita e parë ishte një vizitë pune për shkëmbim eksperience ku grupet pjesëmarrëse vizituan zonat rurale të Korçës (zona Vithkuq) dhe Elbasanit (zonë Shirgjan), ku Fondacioni AgriNetAlbania po zbaton projektin e mbështetur nga WeEffect.

Dita e dytë ishte e fokusuar në hapjen e eventit dhe në dy takime pune shumëkombëshe me temat:

- Forcimi i kapaciteteve të rrjeteve CSO's dhe CSO për të marrë pjesë në mënyrë aktive në planifikimin dhe zbatimin e politikave, për të ndërtuar një shoqëri të fortë civile në zonat rurale, dhe për të rritur zhvillimin rajonal përmes rrjeteve dhe bashkëpunimit.
- "Ndërtimi i partneritetit të rrjeteve CSO's dhe CSO Networks me institucionet me institucionet publike, dhe përfshirja e tyre në vendim - marrje dhe procesin e qeverisjes, për mirëqenien e komuniteteve rurale."

Dita e tretë ishte rezervuar për një Sesion Plenar Final, ku u dhanë konkluzionet, komentet për punën në të ardhmen nga ana e Partneriteti PREPARE, gjithashtu pati edhe reagime dhe komente nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në Shqipëri, nga përfaqësues të Komisionit Evropian edhe përfaqësues nga institucionet evropiane, rrjetet dhe të tjerët. ●



PANAIRI I PRODËHIMEVE BUJQËSORE, BLEGTORALE DHE PUNIMEVE TE DORËS

Më datën 24 shtator 2016, në qytetin e Pukës, Shoqata Agropuka organizoi Panairin e Prodimeve Bujqësore, Blegtorale dhe punimeve të dorës.

Për ndryshim nga vitet e tjera, Panairi i sivjetshëm u zhvillua në Hollin para Pallatit të Kulturës për punimet e dorës, gatimet dhe fabrikat e ujit, ndërsa në Sheshin para Bashkisë Pukë ishin vendosur 27 copë çadra 3 x 3 m dhe ishte rrethuar me rrjet plastike 1m mbi tokë, duke krijuar një sipërfaqe të konsiderueshme për ekspozuesit dhe vizitorët e shumtë.

Qysh në orën 09:00, një grup fëmijësh nga Qerreti, të organizuar dhe përgatitur për këtë rast nga Grupi i Grave Qerret, interpretuan me mjeshtri valle popullore karakteristike të zonës së Pukës, të cilat u mirëpritën dhe u duartrokitën herë pas here nga të pranishmit e shumtë, disa prej të cilëve (përfshirë edhe ekipin e We effect të ardhur nga Stokholmi) iu bashkëngjitën këtyre valleve, duke krijuar një atmosferë të vërtetë festive, saqë Ambasadori Amerikan Donald Lu e quajti Panairin "Festivali i të vjelave të Pukës".

Në panair morën pjesë shumë ekspozues me produkte bujqësore si mollë,

Shkruan: Dr. Vitor Malutaj





Në emër të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Shkodër përshëndeti Drejtori Mustaf Kraja, i cili u ndal në mbështetjen që Ministria e Bujqësisë sipas strategjisë që ka do të japë për zonat malore, duke përfshirë edhe Pukën.

Në emër të donatorit We effect foli zoti Henrik Brundin, i cili vlerësoi Shoqatën Agropuka për rolin e saj në zhvillimin rural dhe uljen e varfërisë në këto zona. Ai vlerësoi në mënyrë të veçantë pjesëmarrjen në këtë panair, larminë e produkteve dhe cilësinë e lartë të tyre.

Pas përshëndetjeve, një grup femijesh të Qendrës Kulturore të femijëve Pukë (QKF) dhanë një koncert të shkurtër artistik, të përgatitur enkas për këtë eveniment.

Gjatë vizitës në panair, Kryetarit të Bashkisë, Ambasadorit Amerikan, autoriteteve lokale, qendrore, donatorit dhe të ftuarve të tjerë iu shpjegua me hollësi për çdo ekspozues dhe produkt që u interesonte.

Në ambientet e Pallatit të Kulturës u zhvillua edhe Tryeza e Rrumbullaket "Prodhimi i djathit të dhisë, sfide për fermerët pukjanë".

Në fund të panairit u shpërndan edhe 10 çmime për fituesit.



rrush, kumbulla, pjeshkë, fiq, arra, fasule, patate, perime të ndryshme, kunguj, kunguj zbururimi etj, produkte blegtorale si djathë, gjizë, gjalpë, mjaltë, vezë, prodhime druri e poçerie, punime dore ne qëndistari dhe sidomos ne veshje popullore tradicionale, produkte te përpunuara ne kushtet e familjes, gatime tradicionale si byrekë, ëmbëlsira etj.

Në panair morën pjesë dhe ekspozuan produktet e tyre një grup nga IKC Kosove, një tavolinë promociionale nga IADK Kosove, si dhe Shoqata e Bletërritësve Tropojë me mjaltë dhe hoje mjalti.

Panairin e hapi z.Sabah Djaloshi, i cili u uroi mirëseardhjen fermerëve dhe personave të tjerë që ekspozuan në këtë panair. Z.Djaloshi falënderoi autoritetet lokale dhe te qeverisjes qendrore për pjesëmarrjen në këtë panair. Gjithashtu z.Djaloshi falënderoi donatorin We effect për mbështetjen financiare të kësaj veprimtarie.

Në emër të Bashkisë Pukë përshëndeti Kryetari i saj z.Gjon Gjonaj, i cili falënderoi Shoqatën Agropuka për realizimin e këtij aktiviteti dhe rolin që luan kjo shoqatë në zhvillimin rural të Bashkisë Puke e me gjere. Gjithash-

tu Kryetari Gjonaj theksoi edhe një herë gatishmërinë e Bashkisë që drejton ai për të bashkëpunuar dhe mbështetur shoqatën Agropuka dhe gjithë shoqërinë civile në aktivitete që ju vijnë në ndihmë fermerëve pukjanë dhe ndikojnë në zhvillimin rural të bashkisë. Gjithashtu zoti Gjonaj u beri thirrje donatorëve të ndryshëm që veprojnë në Shqipëri të mbështesin OJQ-te e Pukës, pasi Puka është rrethi me i varfër në Shqipëri dhe me burime të kufizuara financiare.

Në panair mori pjesë Ambasadori Amerikan në Shqipëri bashkë me familjen e tij, si i ftuar nga AP. Ambasadori Amerikan Donald Lu, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi për ftesën dhe tha se "deri me sot pak e njihja Pukën, por pasi lexova në internet për Pukën- mësova se Puka është një nga qytetërimet më të vjetra shqiptare dhe se Puka është shumë e begatë me minerale dhe ujë të pijshëm, por sot po mësoj se në Puke ka edhe bujqësi e blegtori të zhvilluar si dhe potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit." Ambasadori Lu, përmendi edhe faktin që poeti i njohur shqiptar Migjeni ka punuar e jetuar në Pukë në vitet '30. Ai e mbylli fjalën e tij përshëndetëse duke cituar disa vargje të Migjenit. ●



FFRM



FFRM-ja i organizon dhe bashkon fermerët në nivel nacional, me qëllim të përbashkët që të zgjidhen problemet dhe të përmirësohet prodhimtaria në bujqësi dhe zhvillimi rural në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi kryesor është të jetë organizatë moderne, transparente dhe demokratike e fermerëve e cila është e njohur në nivel nacional dhe i njeh dhe bashkon pjesën më të madhe të bujqve, i përfaqëson dhe i mbron interesat e tyre dhe vepron në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe rajonet rurale në përputhje me nevojat reale të bujqve në Republikën e Maqedonisë. FFRM-ja vepron në nivel nacional, në përputhje me nevojat dhe nevojat e anëtarëve të vetë. Si model i strukturuar hapëron sipas gjurmëve të bujqve suedeze me nënshkrim të marrëveshjes për bashkëpunim me Federatën Suedeze të Fermerëve. Mbi 10.000 njerëz janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të përfshira në organizatë, domethënë: si anëtarë të organeve të menaxhimit, të punësuarit, vullnetarët, pjesëmarrësit në trajnime për punëtori edukuese, pjesëmarrësit në udhëtimet studimore jashtë shtetit,

në organizimin e panairëve dhe shumë formave të tjera. Përveç kësaj, realizohet bashkëpunim intensiv me organizata nga rajoni, siç janë Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Rumania, Sllovenia si dhe me organizata nga shtetet evropiane siç janë Suedia, Franca dhe Holanda. Një prej mjeteve më efikase të FFRM-së për informim dhe edukim është revista e saj mujore "Toka ime" e cila është e vetmja revistë mujore në Republikën e Maqedonisë e cila jep komentet dhe mendimet e bujqve, ekspertëve dhe institucioneve relevante, raporte, këshilla edukuese dhe analiza. Në drejtim të zhvillimit të fermerëve të vegjël, bashkëpunimit rajonal dhe kooperativave, FFRM-ja filloi me realizimin e projektit "Zhvillimi institucional i FFRM-së" i cili realizohet në bashkëpunim me organizatën suedeze We Effect.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe pa-drejtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banorëve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe

synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosovo Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgjiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkanctie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të

Kosovës nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për faktin se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kryesiale: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Kllokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOs) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WOs, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë. Agri-

Net siguron shërbime të zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë. Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.